



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

**RAPORT**  
**(Përfundimtar)**

**Për**

**Mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin në varësi  
të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit**

**INSPEKTORATI SHTETËROR I PUNËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE**

**Tiranë**

**Tiranë, Maj 2024**

## RAPORT

### **Mbikëqyrje në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në institucionin e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe DAP.**

#### **Hyrje**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në zbatim të planit vjetor të mbikëqyrjes për vitin 2023, të miratuar me Vendimin nr. 144, datë 22.12.2022, *“Për miratimin e planit vjetor të punës të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2023”* dhe në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenin 14 dhe nenin 15, të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit në administrimin e shërbimit civil, me Vendimin nr. 70, datë 19.07.2023, *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Departamentit të Administratës Publike”*, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes në institucionin Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, duke përfshirë edhe veprimet administrative të kryera nga Departamenti i Administratës Publike në rolin e njësisë përgjegjëse në këtë institucion.

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH), është krijuar me Vendimin nr. 295, datë 20.03.2013, të Këshillit të Ministrave, *“Për krijimin, organizimin dhe funksionim e ISHPSHSH-së”*, si institucion qendror, buxhetor në varësi të ministrit përgjegjës për punën dhe çështjet sociale. Në mbështetje të këtij vendimi, përmes Urdhrit nr. 1, datë 07.01.2014, të Kryeministrit, *“Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore”*, është miratuar struktura dhe organika e ISHPSHSH-së, e cila ka pësuar disa ndryshime fillimisht me Urdhrin nr. 96, datë 07.06.2016, të Kryeministrit *“Për një ndryshim të urdhrin nr. 1, datë 07.01.2014, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore”* dhe më tej, me Urdhrin nr. 116, datë 31.07.2018, të Kryeministrit *“Për disa ndryshime në urdhrin nr. 1, datë 07.01.2014, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore”*, i ndryshuar.

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, në mbështetje të nenit 2, të këtij ligji, ku përcaktohet në mënyrë të shprehur se, ai zbatohet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik, në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur, apo njësi të qeverisjes vendore, institucioni subjekt mbikëqyrjeje, është përfshirë në fushën e veprimit të ligjit për nëpunësin civil, si institucion në varësi të ministrisë së linjës.

Po kështu, edhe përfshirja e ISHPSHSH-së në listën e institucioneve të administratës shtetërore, në lidhjen nr. 1, (numër rendor 56), që është pjesë e Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar, ka

sjellë si pasojë një regjim juridik të rregullimit të marrëdhënies së punës për punonjësit e këtij institucioni sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar.

Misioni i Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, konsiston në kontrollin, konstatimin, këshillimin, njoftimin, formimin, zbutjen e konflikteve, parandalimin dhe sanksionimin, si dhe garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në fushën e legjislacionit të punës dhe atij të shërbimeve shoqërore.

Aktualisht institucioni funksionon në bazë të Urdhrit nr. 156, datë 24.11.2020, të Kryeministrit, *“Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore”*.

Sipas këtij urdhri, institucioni organizohet në dy nivele, në nivel qendror (*Drejtoria qendrore*) dhe në nivel rajonal (*6 drejtori rajonale*). Referuar kreut II, neni 5, pika 1, e rregullores së brendshme të institucionit, *“Qëllimi dhe detyrat e njësisë organizative të ISHPSHSH-së”*, miratuar me urdhrin nr. 165 datë 13.09.2021, *“Për miratimin e rregullores së brendshme të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore”*.

Procesi i mbikëqyrjes në këtë institucion filloi në datën 24.07.2023, në zbatim të Programit të Mbikëqyrjes nr. 798/1 prot., datë 19.07.2023, miratuar nga Komisioneri dhe me shkresën nr.798/2 prot., datë 19.07.2023, *“Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore”*, u njoftua institucioni i mbikëqyrur për fillimin e këtij procesi.

Ndërsa, me shkresën nr. 798/3 prot., datë 19.07.2023, të Komisionerit, *“Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore”*, është njoftuar Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, si institucion nga i cili varet subjekti i mbikëqyrur.

Gjithashtu, me shkresën nr. 798/4 prot., datë 19.07.2023, të Komisionerit, *“Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore”*, është njoftuar edhe Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse në këtë rast.

Objekti i mbikëqyrjes është verifikimi i situatës së administrimit të shërbimit civil në këtë institucion, për të arritur në konkluzionin se si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, në lidhje me respektimin e skemës së administrimit të shërbimit civil, si dhe të procedurave që ndiqen gjatë aplikimit të instituteve të ligjit.

Në përfundim të procesit të këqyrjes së akteve dhe administrimit të dokumentacionit të nevojshëm të vendosur në dispozicion nga institucionet e përfshira në proces, grupi i punës, i përbërë nga inspektorët Ledina Zhupa, Stela Ndoka, Dorela Halilaj dhe Elvis Qerimaj, nën drejtimin e Drejtorit të Mbikëqyrjes, Altin Shumeli, përpunoi të dhënat dhe përgatiti projekt

raportin e mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin që është subjekt i mbikëqyrjes.

Ky material, me shkresën nr. 283 prot., datë 24.04.2023 u dërgua për njohje, pranë institucionit, duke i lënë 10 ditë kohë për të paraqitur observacionet e tyre në lidhje me gjetjet e grupit të punës.

Subjekti i mbikëqyrur, pasi është njohur me projektraportin dhe gjetjet e grupit të punës, me shkresën nr. 283/1 prot., datë 03.05.2024, ka dërguar të nënshkruar projektraportin pa vërejtje, i cili është administruar në dosjen e mbikëqyrjes.

Gjithashtu, ky material i është dërguar për njohje me shkresën nr. 283/2 prot., datë 24.04.2023, Departamentit të Administratës Publike, në rolin e njësisë përgjegjëse në këtë institucion.

Në vijim të këtij komunikimi, DAP, me shkresën nr. 283/4 prot., datë 23.05.2024, *“Mbi projektraportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil”*, pasi ka shqyrtuar projektraportin e përcjellë, ka dërguar një informacion sqarues në lidhje me procedurën e hartimit dhe miratimit të përshkrimeve të punës në institucionin e mbikëqyrur.

Në përmbajtjen e këtij informacioni, Departamenti i Administratës Publike, sqaron faktin se, përsa i përket procesit të hartimit të përshkrimeve të punës në institucionin e mbikëqyrur, për gjatë vitit 2022, ka pasur përveç komunikimit elektronik të përmendur në përmbajtjen e projektraportit dhe takime fizike me përfaqësues të institucionit të e ISHPSHSH-së, si dhe komunikime me anë të shkresave si më poshtë vijon:

- Me aktin nr. 2630/2 prot., datë 10.05.2022, *“Kthim përgjigje”*, DAP, i ka kërkuar institucionit të mbikëqyrur rishikimin e përshkrimeve të punës për pozicionet *“Përgjegjës Sektori”*, në Sektorin e Mbikëqyrjes së Marrëdhënieve të Punës, *“Specialist”*, në Sektorin e Mbikëqyrjes së Sigurisë dhe Shëndetit në Punës, pranë Drejtorisë së Inspektimit të Punës dhe për pozicionin *“Specialist”*, në Sektorin e Inspektimit, pranë Drejtorisë së Inspektimit të Punës, si dhe
- me aktin nr. 2630/4 prot., datë 01.06.2022, *“Kthim përgjigje”*, përmes të cilës DAP, është dakortësuar pjesërisht me ndryshimet e kritereve për disa pozicione pune por ka kërkuar sërish të rishikohen disa ndarje të përshkrimeve të punës bazuar në komente dhe sygjerime të lëna në këtë shkresë.

Në fakt, këto akte janë administruar edhe nga grupi i punës gjatë këqyrjes së dokumentacionit në institucion dhe ky fakt rezulton i vërtetë. Departamenti i Administratës Publike ka vepruar në përputhje me rregullat e përcaktuara në vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar, si dhe udhëzimin nr. 1, datë 31.05.2017, të Departamentit të Administratës Publike, *“Për hartimin e përshkrimit të*

pozicioneve të punës në shërbimin civil”, akte që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të nenit 19, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për sa i përket veprimeve përpara finalizimit të procesit të hartimit të përshkrimit të punës.

Në këto akte parashikohet se “*Departamenti i Administratës Publike, për institucionet e administratës shtetërore, apo njësia përgjegjëse, për institucionet e tjera pjesë të shërbimit civil, kthejnë për rishikim përshkrimet e punës për pozicionet respektive në rast se vërejnë se ato nuk janë hartuar në bazë dhe në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar.*”

Në këtë rast, konstatohet se komunikimi me institucionin është realizuar por ky proces nuk është finalizuar ende, pasi përshkrimet e punës nuk janë depozituar në Departamentin e Administratës Publike, pasi nuk janë nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm i ministrisë përgjegjëse, në varësi të së cilës është subjekti i mbikëqyrjes.

Në legjislacion, në lidhje me këtë moment parashikohet se: “*Përshkrimet e punës depozitohen në Departamentin e Administratës Publike, për pozicionet e administratës shtetërore, apo njësinë përgjegjëse, për institucionet e tjera, pjesë e shërbimit civil*”.

Në këto rrethana, për të rregulluar situatën e ligjshmërisë në këtë rast, njësia e burimeve njerëzore e institucionit **duhet të reflektojë ndryshimet** për të cilat DAP ka theksuar nevojën për rishikimin e tyre, bazuar në komentet dhe sygjerimet e dhëna, në mënyrë që më tej të vijohet procesi me miratimin e tyre nga organizmat e ngarkuar prej ligjit dhe **depozitimi** pranë Departamentit të Administratës Publike.

### **Drejtimit e mbikëqyrjes**

Mbikëqyrja është orientuar drejt mënyrës së zbatimit në praktikë të instituteve të ligjit për nëpunësin civil, në këto aspekte:

1. Plotësimi i kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në lidhje me statusin e punonjësve dhe nëpunësve aktualë, që do të verifikohet në këto aspekte:
  - Përfshirja e funksionit në shërbimin civil në përputhje me përshkrimin e punës dhe detyrat që realizon ky funksion;
  - Punonjësit ekzistues që janë punësuar në pozicione të shërbimit civil sipas këtij ligji, që janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se 1 vit ose për një periudhë më pak se 1 vit.
  - Rastet e refuzimit të deklaramit të statusit të nëpunësit civil;
  - Si është dokumentuar procedura e ndjekur nga njësia përgjegjëse, në rastin e deklaramit të statusit të punësimit të punonjësve;

- Si është dokumentuar në dosjen e personelit procedura e verifikimit dhe akti i deklarimit të statusit të punësit nga njësia përgjegjëse (*kërkesat e përgjithshme, kërkesat e posaçme, procedura e rekrutimit, akti i emërimit, etj.*).
2. Respektimi i kërkesave ligjore në hartimin e formularit të përshkrimit të punës sipas formatit të përcaktuar nga ligji për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij, që do të verifikohet në këto aspekte:
    - Si është zbatuar procedura e hartimit të përshkrimit të punës dhe formati i miratuar me aktin nënligjor përkatës.
    - Punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, i plotësojnë kërkesat e përgjithshme të përcaktuara në nenin 21, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.
    - Punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, i plotësojnë kërkesat e posaçme, sipas formularit të përshkrimit të punës.
  3. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimin në shërbimin civil.
  4. Rastet e rekrutimeve, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, për periudhën Janar 2020 – Korrik 2023 si dhe situata aktuale e marrëdhënies së punës në shërbimin civil për nëpunësit të cilët janë në marrëdhënie pune në institucionin objekt mbikëqyrje.
  5. Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës, detyrimet e nëpunësit dhe procedura e vendimmarrjes në përfundim të kësaj periudhe.
  6. Transferimi i përkohshëm dhe transferimi i përhershëm dhe si janë respektuar kërkesat ligjore në këto raste (*ristrukturimi dhe ngritja e komisionit përkatës, aktet që materializojnë procesin, si dhe rastet e tjera të transferimit*), për proceset e ndodhura për periudhën Janar 2020 – Korrik 2023.
  7. Përzullimi nga shërbimi civil, sipas rasteve të parashikuara në ligj, duke verifikuar se si janë zbatuar kërkesat ligjore për procedurat që janë zhvilluar në këto raste.
  8. Masat disiplinore dhe respektimi i procedurës ligjore të kërkuar në fazat e zhvillimit të ecurisë disiplinore, kërkesa për fillimin e ecurisë, ngritja e Komisionit të përhershëm.
  9. Vlerësimi i rezultateve në punë dhe si është zhvilluar ky proces për gjashtëmujorin e parë të vitit 2023. Si materializohet procedura e vlerësimit dhe detyrimet ligjore që ligji i ka vendosur aktorëve të këtij procesi gjatë periudhës së vlerësimit (*Zyrtari Raportues, Zyrtari Kundërfirmues, Zyrtari Autorizues*).
  10. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të lirimit nga shërbimi civil: si rezultat i dorëheqjes dhe për shkak të ligjit.

11. Probleme të ndryshme që i kanë lindur njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore (*njësisë përgjegjëse*), gjatë punës për zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Aktet administrative që janë vënë në dispozicion për gjatë mbikëqyrjes janë:

1. Struktura organizative dhe analitike aktuale e institucionit.
2. Struktura organizative dhe analitike e institucionit në fuqi.
3. Listëprezenca dhe listëpagesa e punonjësve të institucionit për muajin Korrik 2023.
4. Formulari i përshkrimit të punës për çdo pozicion që është pjesë e shërbimit civil.
5. Formulari i vlerësimit të punës.
6. Materialet që dokumentojnë procesin e rekrutimit, transferimit, pezullimit, lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë, procedurës së ristrukturimit të institucionit dhe procedurave disiplinore.
7. Dosjet e personelit dhe regjistri i personelit.
8. Materiale të tjera që janë konsideruar të domosdoshme për verifikimin e situatës së shërbimit civil në këtë institucion, gjatë procesit të mbikëqyrjes.

### **Metodologjia e mbikëqyrjes**

Grupi zgjodhi si metodë pune verifikimin e dokumentacionit që ka lidhje me objektin e mbikëqyrjes, i cili administrohet në dosjet individuale të personelit, në arkivin e institucionit dhe nga personi i ngarkuar në lidhje me burimet njerëzore, për çdo nëpunës të emëruar në pozicion pune pjesë e shërbimit civil.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, grupi i punës ndërmoi veprimet e mëposhtme:

- Fillimisht u realizua një takim me \*\*\*\*\*\*, me detyrë “Përgjegjëse në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Përgjithshme”, në cilësinë e personit të ngarkuar në lidhje me menaxhimin e burimeve njerëzore, me të cilën u diskutua në lidhje me objektin dhe drejtimit e mbikëqyrjes, dhe në përfundim u ra dakord në lidhje dhe me dokumentacionin shkresor që duhej të vihej në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes për verifikim.
- U verifikuan pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil, sipas organigramës dhe strukturës analitike aktuale, për institucionin Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.
- U verifikuan të dhënat profesionale, si dhe të dhënat e tjera për marrëdhëniet e punës të çdo nëpunësi civil, lidhur me përmbushjen e kërkesave të posaçme të pozicionit të punës si niveli arsimor, përvoja në punë, e të tjera. U administrua dokumentacioni i kërkuar, ku përfshihen listëprezenca dhe listëpagesa e nëpunësve civilë për muajin Korrik 2023.

- U verifikuan formularët e përshkrimit të punës si dhe formularët e vlerësimit të punës për çdo pozicion pune që është pjesë e shërbimit civil.
- U verifikuan procedurat e rekrutimit, transferimit, pezullimit, lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë, procedurës së ristrukturimit të institucionit dhe procedurave disiplinore.
- Në përfundim, u verifikuan dosjet e personelit dhe regjistri i personelit, si dhe çdo material tjetër që është konsideruar i domosdoshëm për verifikimin e situatës së shërbimit civil në institucionin e mbikëqyrur.

Konstatimet janë të materializuara si tabela më vete (*Tabela nr. 1, Tabela nr. 2*), të cilat janë pjesë e këtij raporti.

### **Përmbajtja e Raportit:**

- 1. Plotësimi i kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në lidhje me statusin e punonjësve dhe nëpunësve aktualë.**

#### ***1.a) Organizimi i pozicioneve të shërbimit civil në institucionin Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.***

Nga analiza e dokumentacionit që është vënë në dispozicion, konstatohet se, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, është institucion që përfshihet për herë të parë në shërbimin civil, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/2103 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Marrëdhëniet e punës për punonjësit e këtij institucioni, deri në datën 26.02.2014, janë rregulluar nëpërmjet ligjit nr. 7661, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Miratimi i ligjit për nëpunësin civil, ka sjellë ndryshime në regjimin e administrimit të burimeve njerëzore në këtë institucion, duke e renditur atë në skemën e shërbimit civil. Mënyra e administrimit të shërbimit civil, për të gjitha institucionet që hyjnë në fushën e veprimit të ligjit aktual për nëpunësin civil, është përcaktuar qartë në këtë ligj, dhe konkretisht, neni 2 i këtij ligji, ka parashikuar në mënyrë të shprehur se, fusha e veprimit të tij shtrihet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik, në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur, apo njësi të qeverisjes vendore.

**Konkluzion:** Aktualisht, rregullat e organizimit dhe funksionimit, të institucionit të mbikëqyrur rregullohen me Vendimin nr. 295, datë 20.03.2013, “Për krijimin, organizimin dhe funksionim e ISHPSHSH-së” të Këshillit të Ministrave. Në përmbajtjen e këtij akti nënligjor të posaçëm, i cili është ende në fuqi dhe konkretisht, në pikën 6 të Kreut III, germa b, të tij, parashikohet se, kryeinspektori në rolin e titullarit të këtij institucioni, në kuadër të funksioneve dhe detyrave të tij, “emëron dhe liron nga detyra personelin e ISHPSHSHS-së, dhe në degët rajonale e vendore në varësi të tij, sipas procedurave dhe legjislacionit në fuqi”.



Sipas këtij akti, marrëdhëniet e punës me këtë institucionin, për pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, rregullohen me ligjin nr.7661, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në përmbajtje të këtij vendimi, parashikohet gjithashtu se, ministri përgjegjës “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e ISHPSHSH-së”, është Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Në vijim të analizës, nisur nga fakti që institucioni i mbikëqyrur, është përfshirë për herë të parë në shërbimin civil dhe në kushtet kur funksionon si institucion juridik, publik dhe buxhetor, në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, (Urdhri nr. 1, datë 07.01.2014, “Për miratimin e strukturës dhe Organikës së Inspektoratit Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore” i Kryeministrit), referuar nenit, 4/1.a, 4/1.f dhe 20, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” dhe vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, emërimet në shërbimin civil, nuk janë më në kompetencën e Kryeinspektorit (Titullarit të institucionit), por realizohen nëpërmjet një procedure konkurrimi të hapur nga Departamenti i Administratës Publike, ashtu si ndodh aktualisht në praktikë.

Pavarësisht këtij fakti, u konstatua se, ky ndryshim kompetencash **nuk është pasqyruar** në aktin që rregullon krijimin, organizimin dhe funksionimin e këtij institucioni.

Nga sa analizuam më sipër, **vlerësojmë se**, institucioni i mbikëqyrur, në bashkëpunim me njësinë përgjegjëse (DAP), duhet të marrin masat e duhura, për të materializuar ndryshimet përkatëse në VKM-në nr. 295, datë 20.03.2013, “Për krijimin, organizimin dhe funksionim e ISHPSHSH-së”, për të pasqyruar ndryshimet që kanë ndodhur me hyrjen në fuqi të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

#### ***1. b) Struktura dhe organika e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, para ristrukturimit, viti 2018.***

Sipas strukturës miratuar me Urdhrin nr.116, datë 31.07.2018, të Kryeministrit “Për disa ndryshime në Urdhrin nr. 1 datë 07.01.2014, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore”, i ndryshuar, rezulton se, ka qenë i organizuar me 154 pozicione pune gjithsej, nga të cilat **144** pozicione pune pjesë e shërbimit civil dhe konkretisht **35** punonjës në nivel qendror dhe **109** punonjës në nivel rajonal. Duke vlerësuar klasifikimin e këtyre pozicioneve në shërbimin civil, sipas përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, në institucionin e mbikëqyrur, për periudhën në fjalë, paraqiten si më poshtë:

- Nëpunës civil të nivelit të mesëm drejtues, 1 pozicion pune ose 1 % të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, që i përket pozicionit, “Zëvendës Kryeinspektor/ Drejtor Drejtorie, kategoria e pagës II-b”;
- Nëpunës civilë të nivelit ekzekutiv, 143 pozicione pune ose 99 % të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, të cilat i përkasin:
  - ✓ 3 pozicione pune me emërtesën “Drejtor Drejtorie”, kategoria e pagës III-a;
  - ✓ 7 pozicione pune me emërtesën “Përgjegjës Sektori”, kategoria III-a/1;
  - ✓ 12 Pozicione pune me emërtesën “Titullar i degës rajonale”, në degët rajonale kategoria e pagës III-b.
  - ✓ 6 pozicione pune me emërtesën “Përgjegjës Sektori Rajonal”, kategoria e pagës IV-a
  - ✓ 15 pozicione pune me emërtesën “Inspektor” në Drejtorinë qendrore, kategoria e pagës III-b.
  - ✓ 7 pozicione pune me emërtesën “Specialist” (3 specialist në qendër kategoria IV-a dhe 4 specialist rajonal kategoria IV-b).
  - ✓ 93 pozicione pune me emërtesën “Inspektor i degës rajonale”, kategoria e pagës IV-b.

Situata e përgjithshme e plotësimit të pozicioneve të punës për këtë periudhë është:

- **144 pozicione pune nëpunës civil**, të plotësuar në këtë mënyrë:
- 123 pozicione pune të plotësuar me nëpunës civil, në përputhje me ligjin;
- 12 pozicione pune të plotësuar me student të ekselencës;
- 9 pozicione të lira.

Konstatohet se emërimi, lirimi ose shkarkimi i Inspektorit të përgjithshëm, që është edhe titullari i institucionit, është në kompetencën e Kryeministrit dhe procedura rregullohet në nenin 9 të ligjit të posaçëm, nr. 9634, dt. 30.10.2006, “Për inspektimin e punës dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës”, i ndryshuar.

### **1.c) Situata e administrimit të burimeve njerëzore në momentin e mbikëqyrjes.**

Në referencë të dokumentacionit të vënë në dispozicion, vërehet se ky subjekt aktualisht funksionon mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Urdhrin nr. 156, datë 24.11.2020, të Kryeministrit “Për Miratimin e Strukturës dhe Organikës së Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore”. Sipas kësaj strukture, rezulton se institucioni në fjalë, në momentin e mbikëqyrjes ka gjithsej 165 pozicione pune, të cilat kategorizohen:

- ✓ 153 punonjës janë në pozicione pune, që konsiderohen pjesë e shërbimit civil, ose rreth 93 % të pozicioneve të përgjithshme të punës.
- ✓ 12 punonjës janë në pozicione pune që kryejnë funksione administrative, ose rreth 7 % e pozicioneve të përgjithshme të punës, që i përkasin 1 pozicion pune me emërtesën Kryeinspektor i ISHPSHSH-së, 1 pozicion pune me emërtesën Koordinator i rrjetit

*Antikorrupsion të Koordinatorëve Antikorrupsion dhe 10 punonjës mbështetës nga të cilët (7 në qendër dhe 3 në drejtoritë rajonale).*

Duke vlerësuar klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil, sipas përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, **153** pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil në këtë institucion, klasifikohen si më poshtë:

- Nëpunës civil të nivelit të mesëm drejtues, **1** pozicion pune ose 0.5 % të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, që i përket pozicionit, “Zëvendëskryeinspektor/Drejtor në Drejtorinë e Inspektimit të Punës, kategoria e pagës II-b”);
- Nëpunës civil të nivelit të ulët drejtues, **2** pozicione pune ose 1.5 % të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, në pozicionin “Drejtor Drejtorie, kategoria e pagës III-a”);
- Nëpunës civil të nivelit ekzekutiv, **150** pozicione pune ose 98 % të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, që i përkasin:
  - ✓ 7 pozicione pune “Përgjegjës Sektori kategoria e pagës III-a/1”;
  - ✓ 6 pozicione pune “Kryeinspektor në Drejtoritë Rajonale kategoria e pagës III-b”;
  - ✓ 14 pozicione pune “Përgjegjës Sektori në Drejtoritë Rajonale kategoria e pagës IV-a”;
  - ✓ 118 pozicione pune “Inspektor”;
  - ✓ 5 pozicione pune “Specialist”.

Theksojmë se, në institucionet e varësisë, ndarja në pozicionin “Kryeinspektor në Drejtoritë Rajonale dhe Përgjegjës Sektori”, janë për të evidentuar hierarkinë administrative, ndërkohë që këto pozicione sipas nenit 19, ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, janë klasifikuar në kategorinë ekzekutive.

Nisur nga sa më sipër, vërehet se, në përmbajtje të saj, struktura aktuale është e përbërë nga 6 drejtori rajonale, krahasuar me strukturën e miratuar me Urdhërin nr.116, datë 31.07.2018, të Kryeministrit “Për disa ndryshime në Urdhërin nr. 1 datë 07.01.2014, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore”, në përbërjen e saj kishte 12 degë rajonale.

Ndërkohë, procesi i ristrukturimit të institucionit do të trajtohet me hollësi në pikën 6 të këtij materiali.

Nisur nga përmbajtja e strukturës, rezulton se, ajo është e organizuar, sipas parimeve të organizimit dhe funksionimit të administratës shtetërore në tërësi dhe institucioneve të varësisë në veçanti, të përcaktuara në nenin 18, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, Kreu III, “Organizimi i brendshëm i institucioneve të administratës shtetërore”, Seksioni 2, “Institucionet e varësisë”. Klasifikimi i pozicioneve të shërbimit civil në kategorinë e lartë drejtuese, të mesme drejtuese, të ulët drejtuese dhe ekzekutive, është parashikuar në nenin 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Në mbështetje të kësaj dispozite, ka dalë vendimi nr. 142, datë 12.3.2014, i Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura ”*, i ndryshuar, ku në pikën 5, të Kreut II, ka përcaktuar klasat e zbatueshmërisë për secilën kategori të shërbimit civil, si dhe emërtesën e pozicioneve të punës që i përkasin secilës klasë, e cila gjen zbatim edhe në strukturën e subjektit të mbikëqyrur.

Gjithashtu, struktura organizative për pozicione të punës, pjesë e shërbimit civil dhe niveli i pagave, rezulton në përputhje me përcaktimet e Vendimit nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve..., institucionet në varësi të ministrave të linjës....”*, ku përfshihet institucioni *Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore*”.

Ky akt nënligjor është evidentuar, pasi ka qënë në fuqi në momentin e mbikëqyrjes, pasi aktualisht, ky akt është shfuqizuar dhe institucioni në fjalë është përfshirë në një proces të ri organizimi, bazuar në reformën e pagave që është aplikuar në institucionet e administratës shtetërore dhe institucioneve të pavarura dhe që është materializuar në Vendimin nr. 325, datë 8.05.2023, të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e strukturës së pagave, dhe shtesave të tjera mbi pagën..., institucionet në varësi të ministrave të linjës....”*, ku institucioni në fjalë parashikohet në në pikën 1/ç, të këtij vendimi, Lidhja nr.10.

Konstatohet se Rregullorja e Brendshme, e cila përcakton përgjegjësitë dhe detyrat kryesore mbi të cilat funksionon secili pozicion pune në këtë institucion është miratuar me urdhrin nr. 165 datë 13.09.2021, *“Miratimin e rregullores së brendshme të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore”*, të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë (*aktualisht Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit*).

Në mënyrë të detajuar, situata e shërbimit civil është pasqyruar në tabelën **Aneks nr. 1** - *“Akte që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil ”*, e cila është pjesë përbërëse e këtij raporti.

***1.d) Zbatimi i ligjit gjatë procesit të deklarimit të statusit të punësimit në raport me kohë zgjatjen e punësimit dhe plotësimin e kërkesave specifike të pozicionit të punës nga punonjësit, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar***

Një aspekt i rëndësishëm i procesit të mbikëqyrjes është verifikimi i plotësimin të kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, në lidhje me statusin e punonjësve dhe nëpunësve aktualë, të cilët kanë qënë në marrëdhënie pune në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil.

Bazuar në ligjin nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, neni 4, shkronja “f”, Departamenti i Administratës Publike, paraqitet si njësi përgjegjëse për institucionin e mbikëqyrur. Ligji për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, e ngarkojnë njësinë përgjegjëse (DAP), me disa detyra dhe përgjegjësi, në kuadër të garantimit të një shërbimi

civil të qëndrueshëm, ndër të cilat edhe deklarin e statusit të punësimit, për të gjithë nëpunësit dhe punonjësit të cilët në datën e fillimit të efekteve të ligjit, ishin të punësuar në pozicione të shërbimit civil. Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se:

Në zbatim të akteve rregullative si më sipër, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore pranë institucionit të mbikëqyrur, pasi ka evidentuar pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, i ka dërguar njësisë përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike, me shkresën nr. 1476 prot., datë 26.05.2014 “*Dosjet e punonjësve të ISHPSHSH-së*”, listën e plotë të punonjësve; materialet që përmbanin të dhëna lidhur me mënyrën dhe kohëzgjatjen e punësimit; aktet individuale të emërimit, si dhe materialet shkresore me të dhënat individuale të çdo punonjësi të punësuar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil.

Departamenti i Administratës Publike, pas marrjes së dokumentacionit të mësipërm, për çdo të punësuar në pozicione pune të shërbimit civil, ka verifikuar periudhën e punësimit, nëse ishte më shumë se një vit apo më pak se një vit, si dhe plotësimin e kërkesave të përgjithshme dhe të kërkesave të posaçme për vendin e punës dhe në përfundim të këtyre verifikimeve, me aktin nr. 1332/132 prot., datë 30.10.2014 “*Verifikimi i statusit të nëpunësve dhe punonjësve aktual*” ka përfunduar procedurën e deklarin të statusit të punësimit për të gjithë punonjësit e institucionit.

Me aktin nr. 1332/93 prot., datë 30.10.2014 “*Mbi statusin e punonjësve që nuk plotësojnë nivelin e kërkuar të diplomës*”, Departamenti i Administratës Publike, ka dërguar listën e plotë të punonjësve të punësuar në pozicione pune pjesë të shërbimit civil, të cilët nuk përmbushnin nivelin e kërkuar të diplomës. Në vijim të këtij komunikimi titullari i institucionit të mbikëqyrur ka marrë masat e duhura për lirimin e tyre nga detyra me arsyetimin se, nuk plotësonin kërkesat e përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës.

Në përfundim me aktin nr. 1332/94 prot., datë 30.10.2014 “*Njoftim*”, Departamenti i Administratës Publike, ka njoftuar institucionin në lidhje me punonjësit të punësuar në pozicione pune pjesë të shërbimit civil, të cilët nuk kanë plotësuar kriteret për të qenë nëpunës civil.

Në momentin e mbikëqyrjes, institucioni ka gjithsej **153 pozicione pune të cilat janë vlerësuar nga njësia përgjegjëse, si pjesë e shërbimit civil**, nga të cilat:

- ✓ **127** pozicione pune të plotësuar me nëpunës civil;
- ✓ **8** pozicione pune të plotësuar me student të ekselencës;
- ✓ **18** pozicione pune janë të lira. Bëhet fjalë për pozicionet:
  - “*2 - Inspektor, në Sektorin e Analizës së Riskut*”;
  - “*1- Inspektor, në Sektorin e Inspektimit Drejtoria Rajonale Durrës*”;
  - “*2 - Inspektor, në Sektorin e Inspektimit Drejtoria Rajonale Berat*”;
  - “*3- Inspektor, në Sektorin e Inspektimit Drejtoria Rajonale Fier*”;

- “1- Inspektor, në Sektorin e Inspektimit Drejtoria Rajonale Vlorë”;
- “1- Inspektor, në Sektorin e Inspektimit Drejtoria Rajonale Kukës”;
- “1- Inspektor, në Sektorin e Inspektimit Drejtoria Rajonale Korçë”;
- “2- Inspektor, në Sektorin e Inspektimit Drejtoria Rajonale Elbasan”;
- “3- Inspektor, në Sektorin e Inspektimit Drejtoria Rajonale Shkodër”;
- “1- Inspektor, në Sektorin e Inspektimit Drejtoria Rajonale Lezhë”;
- “1- Inspektor, në Sektorin e Inspektimit Drejtoria Rajonale Sarandë”.

Kategoria e nëpunësve civilë (127 pozicione pune pozicione) është e plotësuar në këtë mënyrë:

- ✓ Në 31 raste, nga njësia përgjegjëse është bërë deklarimi i statusit të punësimit si “nëpunës civil”, për punonjës të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë më shumë se një vit.
- ✓ Në 22 raste, nga njësia përgjegjëse është bërë deklarimi i statusit të punësimit si “nëpunës civil në periudhë prove”, për punonjës të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë më pak se një vit.
- ✓ Në 66 raste, nga njësia përgjegjëse është zhvilluar procedura e rekrutimeve, pas momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
- ✓ Në 6 raste, pozicionet e punës janë të zëna me nëpunës të transferuar në kuadër të ristrukturimit të institucioneve respektive (*bëhet fjalë për nëpunësit civil \*\*\*\*\**, \*\*\*\*\*), \*\*\*\*\*);
- ✓ Në 2 raste, pozicionet e punës janë të zëna me nëpunës civil gjyqfitues (*bëhet fjalë për nëpunësit civil, \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\**).

**Konkluzion:** Nga verifikimi i dokumentacionit përkatës, në lidhje me deklarin e statusit të punësimit, i cili është i administruar në anekset që janë pjesë e raportit, konstatohet se:

- Procedurat e deklarin të statusit të punësimit “nëpunës civil”, janë kryer në respektim të kërkesave të nenit 67, pika 3, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
- Këta punonjës, në datën 26 Shkurt 2014, ishin të punësuar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, kohëzgjatja e periudhës së punësimit ishte më e madhe se një vit dhe ata plotësojnë kriterin e nivelit arsimor të diplomës së arsimit të lartë, për pozicionin përkatës të punës.
- Nga këqyrja dhe analiza që i është bërë akteve të emërimit, nivelit të diplomës së arsimit të lartë për pozicionet përkatëse të punës dhe momentit të fillimit të marrëdhënieve financiare, rezulton e vërtetuar se, në të gjitha këto raste, këta punonjës, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, kanë pasur më shumë se një vit vjetërsi, në detyrën që mbanin në datën 26.02.2014 dhe i plotësojnë kërkesat për tu deklaruar si nëpunës civil.

- Për këtë kategori nëpunësish, me të drejtë njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit, si “*nëpunës civilë*”, nëpërmjet vendimeve përkatëse të nxjerra, në muajin Tetor 2014, të cilat janë të pasqyruara në mënyrë të detajuar në **Aneksin nr. 1** – “*Akte që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil*”, i cili është pjesë përbërëse e këtij raporti.
- Në lidhje me punonjësit e deklaruar me statusin e punësimit “*Nëpunës civil në periudhë prove*”, konstatohet se procedurat e deklarimit të statusit të punësimit, janë kryer në respektim të kërkesave të nenit 67, pika 3 dhe 4, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dhe brenda afatit të përcaktuar në vendimin nr. 116, datë 05.03.2014, i Këshillit të Ministrave, “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 30.10.2014).* Nga këqyrja dhe analiza që i është bërë akteve të emërimit, nivelit të diplomës së arsimit në përputhje me pozicionet përkatëse të punës dhe momentit të fillimit të marrëdhënieve financiare, rezulton e vërtetuar se, për punonjësit \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* , që në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit (datën 26.02.2014), nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, kanë qënë në pritje të plotësimit të nivelit arsimor, në momentin e deklarimit të statusit të punësimit në përfundim të periudhës së provës, këta nëpunës kanë plotësuar nivelin e diplomës së arsimit në përputhje me pozicionet përkatëse.
- Konstatohet se punonjësit të cilët janë deklaruar “*Nëpunës civil në periudhë prove*”, tashmë kanë përfunduar periudhën e provës dhe kanë kryer me sukses trajnimin e detyrueshëm për nëpunësit civilë. Në dosjet e tyre janë administruar çertifikata përkatëse e lëshuar nga Shkolla e Administratës Publike (ASPA) si dhe vendimi i eprorit direkt, por mungojnë aktet për caktimin e nëpunësit me të vjetër, të së njëjtës kategori ose të një kategorie më lartë nën kujdesin e të cilit do të kryenin detyrat punonjësit gjatë periudhës së provës.
- Ndërkohë, është finalizuar procedura me vendimin e konfirmimit si nëpunës civil, në përputhje me nenin 24, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, vendim i cili i është dërguar DAP më shkresën nr. 994 prot., datë 01.07.2015, të titullari të Institucionit “*Vendimet e eprorit direkt për nëpunësit që kanë përfunduar periudhën e provës*”.

Në përfundim të analizës rezulton se njësia përgjegjëse, ka vepruar drejt në lidhje me deklarimin e statusit të punësimit si nëpunës civilë në periudhë prove, pasi punonjësit i përmbushin kushtet e parashikuara në nenin 67, pika 4, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe në aktet nënligjore që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të tij, por nga ana tjetër duhet të tregohet kujdes ***në lidhje caktimin e nëpunësit nën kujdesin e të cilit do të***

*kryejë detyrat secili punonjës në periudhën e provës, në zbatim të dispozitave të mësipërme, akt i cili duhet të jetë në dosjen përkatëse të secilit punonjës.*

***1.e)Procesi i deklarimit të statusit të punësimit në raport me afatet ligjore:***

Vendimi nr. 116, datë 05.03.2014, i Këshillit të Ministrave, “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (ndryshuar me vendimin nr. 532, datë 06.08.2014 të Këshillit të Ministrave; ndryshuar me vendimin nr. 627, datë 24.09.2014, të Këshillit të Ministrave), ka parashikuar procedurat e hollësishme që duhet të kryejë njësia përgjegjëse për të realizuar deklarimin e statusit të punësimit për punonjësit dhe nëpunësit aktualë si dhe afatin brenda të cilit duhet të përfundojë i gjithë ky proces. Në Kreun IV, të vendimit si më sipër, është përcaktuar se: “*Procedura e deklarimit të statusit të punësimit përfundon jo më vonë se 120 (njëqind e njëzetë) ditë nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi. ... Në çdo rast, shtyrja e afatit nuk mund të jetë më vonë se data 30 tetor 2014 ...*”.*

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes u konstatua se, Departamenti i Administratës Publike, si njësi përgjegjëse për institucionin e mbikëqyrur, i ka përfunduar procedurat e deklarimit të statusit të punësimit në datën 30.10.2014, pra **brenda afatit** të vendosur në aktin nënligjor.

*(Të dhënat që pasqyrojnë realizimin e procedurës së deklarimit të statusit të punësimit, siç janë: akti për fillimin e marrëdhënieve të punës; akti i deklarimit të statusit të punësimit “Nëpunës civil” apo “Nëpunës civil në periudhë prove”, si dhe të dhënat lidhur me përmbushjen e detyrimeve të periudhës së provës, janë të pasqyruara në mënyrë analitike në anekset nr. 1 dhe nr. 2, të hartuara nga grupi i punës dhe që i bashkëlidhen raportit si pjesë përbërëse e tij).*

**2. Respektimi i kërkesave ligjore në hartimin e formularit të përshkrimit të punës sipas formatit të përcaktuar nga ligji për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij, është verifikuar në këto aspekte:**

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, për të gjitha pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, u verifikuan përshkrimet e punës, për të vlerësuar nëse janë respektuar rregullat e përcaktuara në vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar, si dhe udhëzimin nr. 2, datë 07.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, “*Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil*”, akte që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të nenit 19, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Më konkretisht, rregullat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, miratimin dhe bërjen efektive të strukturës dhe organikës së institucioneve të administratës shtetërore, janë të



përcaktuara në pikat nga 30 deri në 40, të Vendimit nr. 893, datë 17.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”.

Detyrimin për hartimin e përshkrimeve të punës në momentin kur ndryshon mënyra e organizimit të institucionit, e parashikon edhe Vendimi nr. 142, datë 12.3.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar. Në mënyrë të shprehur pika 14, e kreut IV, të këtij akti nënligjor parashikon se:

*“Përshkrimet e punës hartohen kur krijohen institucione të reja, kur ndryshon mënyra e organizimit të institucionit, apo kur kanë ndodhur ndryshime ose miratime të legjislacionit specifik mbi bazën e të cilit funksionon institucioni”.*

Në respektim të rregullave të vendosura nga aktet nënligjore si më sipër, subjektet e ngarkuara me përgjegjësinë e hartimit, miratimit e administrimit të përshkrimeve të punës siç janë: njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore, analisti i punës, eprori direkt i pozicionit respektiv të punës, Sekretari i Përgjithshëm i institucionit dhe njësia përgjegjëse, duhet të hartojnë përshkrimet e reja të punës, për të gjitha pozicionet e shërbimit civil sipas strukturës së re.

Me qëllim zbatimin e unifikuar të procedurës së përshkrimit të pozicioneve të punës, Departamenti i Administratës Publike ka miratuar Udhëzimin nr. 1, datë 31.05.2017, “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”, i cili përcakton elementët e përshkrimit të pozicionit të punës.

Nga këqyrja e akteve në subjekt, si dhe referuar procesverbalit të mbajtur në datën 31.10.2023, midisi grupit të punës dhe \*\*\*\*\*, në cilësinë e personit të ngarkuar për të kryer detyrat në lidhje me burimet njerëzore të institucionit të mbikëqyrur, u konstatua se, përshkrimet e punës janë hartuar në mënyrë elektronike, janë printuar dhe janë të nënshkruara nga zyrtarët përgjegjës të ngarkuar nga ligji, sipas udhëzimit nr. 2, datë 07.04.2014 të Departamentit të Administratës Publike, “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar rezulton se, bazuar në pikën 19, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse për institucionet e administratës shtetërore, në datën 09.11.2022, ka pasur komunikim elektronik me njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit të mbikëqyrur, për të kërkuar rishikimin e disa formularëve të përshkrimeve të punës.

Mbështetur në sa parashikohet në këtë akt rregullativ, theksojmë se, e drejta e Departamentit të Administratës Publike, për të rikthyer për rishikim përshkrimet e punës, nënkupton edhe detyrimin e këtij organi për të aprovuar në mënyrë shkresore rregullshmërinë e përshkrimeve

të punës, duke e njoftuar zyrtarisht institucionin dhe Sekretarin e Përgjithshëm të ministrisë së linjës, se përshkrimet e punës janë në bazë dhe në përputhje me legjislacionin specifik të fushës, me qëllim që ata të vijnë më tej me procedurën e depozitimit të tyre pranë Departamentit të Administratës Publike.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, në këtë rast u konstatua se, procedura e bashkëpunimit ndërmjet strukturave/nëpunësve përgjegjës për realizimin e këtij procesi, që janë: analisti i punës/ eprori direkt i pozicionit përkatës/Departamenti i Administratës Publike, **është realizuar** në formë elektronike, në formë shkresore dhe me takime fizike. Përshkrimet e punës janë plotësuar në sistemin elektronik, të administruar nga njësia përgjegjëse (DAP). Në vijim, i gjithë procesi rezultoi të jetë zhvilluar në format elektronik dhe në përfundim, përshkrimet e punës janë printuar nga sistemi dhe janë nënshkruar nga eprori direkt. Bashkëpunimi në sistemin elektronik, ndërmjet analistit të punës dhe specialistit të DAP-it, ka të bëjë vetëm me fazën e krijimit apo hartimit të përshkrimeve të punës që është faza e parë e këtij procesi.

Në këtë rast rezultoi se, Departamenti i Administratës Publike, **ka lënë sygjërime dhe komente** në formularët e përshkrimit të punës, por ky proces **ende nuk ka marrë miratimin** dhe nënshkrimin e Sekretarit të Përgjithshëm të ministrisë përgjegjëse për këtë institucion.

Aktualisht, Departamenti i Administratës Publike, në rolin e njësisë përgjegjëse të institucionit vijon të shpallë vendet vakante dhe të emërojnë nëpunës civil në institucionin e ISHPSHSH-së duke marrë për bazë përshkrimet e punës, të hartuara sipas procedurës që evidentuam më sipër.

Ndërkohë, rezultoi se, gjatë mbikëqyrjes, me aktin nr. 1014/1 prot., datë 27.06.2023, “*Rishikimin e strukturës organizative*”, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, (aktualisht institucioni është në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit), bazuar në VKM nr. 325 datë 31.05.2023, i ka kërkuar institucionit të mbikëqyrur rishikimin e strukturës organizative. Në vijim ISHPSHSH, me aktin nr. 1014/4 prot., datë 24.08.2023 ka dërguar pranë MFE-së propozimin për ndryshimin e strukturës organizative dhe numrit të punonjësve.

**Konkluzion:** Nga sa analizuar më sipër konstatohet se:

- Institucioni i mbikëqyrur **ka realizuar** procesin e hartimit dhe miratimit të përshkrimeve të punës, nga ana e subjekteve të ngarkuar prej ligjit, deri tek Sekretari i Përgjithshëm.
- Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së linjës **nuk i ka nënshkruar** përshkrimet e punës.
- Departamenti i Administratës Publike, duhet të ketë një rol më aktiv për finalizimin e procesit, deri në **depozitimin e formularit të përshkrimit** të punës sipas kërkesave të ligjit pranë këtij institucioni, për të siguruar përmbushjen e kriterëve dhe për të paraprirë ndryshimet strukturore që mund të ndodhin në të ardhmen në këtë institucion.

### **3. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil**

Në zbatim të programit të mbikëqyrjes, në të cilin është përcaktuar se, mbikëqyrja përfshin ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, për periudhën kohore nga momenti i fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e në vijim, u verifikua planifikimi i nevojave për rekrutim në shërbimin civil për vitin 2023, duke u bazuar në përcaktimet e nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 108, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”.

Nga këqyrja e akteve rezulton se institucioni i mbikëqyrur ka planifikuar nevojat për rekrutim në shërbimin civil, me aktin. 30/1 prot., datë. 09.01.2023, “Mbi planifikimin e vendeve vakante në ISHPSHSH, për vitin 2023”, të cilat i ka dërguar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, (aktualisht Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit), si dhe Departamentit të Administratës Publike, në rolin e njësisë përgjegjëse të institucionit.

Në këto rrethana, struktura që përgjigjet për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit të mbikëqyrur, **ka respektuar detyrimet** në lidhje me procesin e planifikimit të nevojave për rekrutim në shërbimin civil për vitin 2023, duke u bazuar në përcaktimet e nenit 18, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”.

### **4. Rastet e rekrutimeve, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, për periudhën Janar 2020 - Korrik 2023 dhe situata aktuale e marrëdhënies së punës në shërbimin civil për nëpunësit të cilët janë në marrëdhënie pune me institucionin objekt mbikëqyrje.**

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, u verifikuan rastet e emërimeve në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur dhe lëvizjes paralele si dhe emërimet në kategorinë e ulët e të mesme drejtuese nëpërmjet lëvizjes paralele ose ngritjes në detyrë.

Konstatohet se, për periudhën objekt mbikëqyrje Janar 2020 - Korrik 2023, në institucionin e mbikëqyrur janë realizuar:

- **29 emërime**, nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive;
- **1 emërim**, nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil në kategorinë e ulët drejtuese, me procedurë të hapur edhe për kandidatë nga jashtë shërbimit civil (20% pranim nga jashtë);
- **9 emërime**, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese;

- **4 emërimet**, nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese.

Duhet të evidentojmë në këtë moment se Departamenti i Administratës Publike, në rolin e njësisë përgjegjëse për institucionin e mbikëqyrur, ka realizuar procedurat e konkurrimit dhe pas përfundimit të procedurave të ankimit, ka shpallur fituesin dhe ka nxjerrë aktin e emërimit të kandidatit fitues.

*Procedura në këtë rast parashikon se DAP-i shpall procedurën e konkurrimit për secilin pozicion duke e publikuar në faqen e tij zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”; krijon Komitetin e Përherhëm të Pranimiit për nivelin ekzekutiv; Komitetin e Pranimiit për Lëvizjen Paralele; Komitetin e Pranimiit për Ngritjen në Detyrë, të cilët bëjnë vlerësimin e kandidatëve. Ky është një proces që ndiqet në vijimesi gjatë gjithë vitit kalendarik, nga një grup i posaçëm, i ngritur me urdhër të Komisionerit, proces për të cilin miratohet një raport vlerësimi, i cili publikohet edhe në faqen zyrtare të Komisionerit.*

Në mënyrë më të detajuar, në lidhje me procesin e rekrutimit konstatojmë si më poshtë:

✓ ***Emërimet me procedurën e pranimiit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive.***

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se, në institucionin e mbikëqyrur janë kryer **29 emërimet**, me procedurën e pranimiit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive.

Në rastin e institucionit të mbikëqyrur, në zbatim të nenit 22, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nëpërmjet pranimiit në shërbimin civil përmes konkurrimit të hapur, me akte emërimi të nxjerrë nga njësi përgjegjëse janë emëruar “Nëpunës civil në periudhe prove”:

- Gjatë vitit 2020, janë emëruar **11** nëpunës;
- Gjatë vitit 2021 janë emëruar **6** nëpunës;
- Gjatë vitit 2022 janë emëruar **11** nëpunës;
- Ndërsa në vitin 2023, është realizuar vetëm **një** procedurë konkurrimi.

Aktet administrative që materializojnë procedurat e rekrutimit janë të pasqyruara në aneksin 1 dhe 2, që janë pjesë e këtij raporti.

✓ ***Një rast emërimi me procedurën e pranimiit në shërbimin civil në kategorinë e ulët drejtuese, (20% me pranim të kandidatëve edhe nga jashtë shërbimit civil).***

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se, në institucionin e mbikëqyrur është kryer emërimi me procedurën e pranimiit në shërbimin civil në kategorinë e ulët drejtuese, në një rast dhe bëhet fjalë për nëpunësen \*\*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr.

4606 prot., 05.10.2020 të Departamentit të Administratës Publike, në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve

- ✓ **Emërimet me procedurën e lëvizjes paralele në kategorinë ekzekutive, të ulët apo të mesme drejtuese.**
- Në vitin 2021, janë realizuar **6** procedura me anë të lëvizjes paralele. Bëhet fjalë për punonjësit:
  - \*\*\*\*\*, emëruar nr. 4577 prot., datë 10.08.2021, të DAP, në pozicionin e punës “Inspektor në Sektorin e Analizës së Riskut në Tiranë” (drejtori qëndrore nga kategoria IV-b në III-b);
  - \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 4575 prot., datë 10.8.2021, në pozicionin e punës “Inspektor në Sektorin e Riskut”;
  - \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 4574 prot., datë 10.8.2021, në pozicionin e punës “Inspektor në Sektorin e Riskut”;
  - \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 2175 prot., datë 30.03.2021, në pozicionin e punës “Përgjegjës në Sektorin e Riskut”;
  - \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 2149 prot., datë 29.03.2021, në pozicionin e punës “Përgjegjës në Sektorin e Inspektimit, Dibër”;
  - \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 2203 prot., datë 31.3.2021, në pozicionin e punës “Kryeinspektor, Drejtoria Rajonale, Gjirokastrë”.
- **Në vitin 2022, janë realizuar 3, procedura me anë të lëvizjes paralele.** Bëhet fjalë për punonjësit:
  - \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 3721 prot., datë 10.6.2022, në pozicionin e punës “Inspektor në Sektorin e Riskut”;
  - \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 3722 prot., datë 10.06.2022, në pozicionin e punës “Inspektor në Sektorin e Inspektimit Dibër”;
  - \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 97 prot., datë 9.5.2022, në pozicionin e punës “Përgjegjës në Sektorin e Inspektimit, Korçë”.
- ✓ **Emërimet me procedurën e ngritjes në detyrë në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese.**

Me procedurën e ngritjes në detyrë në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, për periudhën e mbikëqyrur janë realizuar **4 emërimet**: 1 procedurë në vitin 2020; 2 procedura në vitin 2021 dhe një procedurë për vitin 2022. Bëhet fjalë për punonjësit:

- \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 6108 prot., datë 19.10.2020, në pozicionin “Kryeinspektor” në Drejtorinë Rajonale Shkodër;
- \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 5634 prot., datë 12.10.2021, në pozicionin “Zëvendëskryeinspektor/Drejtor” në Drejtorinë e Inspektimit të Punës;

- \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 2353 prot., datë 8.4.2021, në pozicionin “Përgjegjës” në Sektorin e Analizës së Riskut;
- \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 4332 prot., datë 12.7.2022, në pozicionin “Përgjegjës” në Sektorin e Mbikëqyrjes së Marrëdhënieve të Punës.

Në përfundim të kësaj analize rezulton se në momentin e kryerjes së verifikimit në institucion, nëpunësit e punësuar në pozicione të shërbimit civil, janë të emëruar nëpërmjet procedurës së pranimit në kategorinë ekzekutive (në **29** raste); me procedurën e lëvizjes paralele në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese (në **9** raste); me procedurën e ngritjes në detyrë në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese (në **4** raste) dhe me procedurën e pranimit në shërbimin civil në kategorinë e ulët drejtuese me 20% pranim nga jashtë (**1** rast).

Procesi i pranimit në shërbimin civil, në nivel ekzekutiv, dhe procedura e ngritjes në detyrë, bazuar në përcaktimet e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; vendimin nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar dhe vendimin nr. 242, datë 18.3.2015 të Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar, janë kryer nga njësia përgjegjëse, që në këtë rast, është Departamenti i Administratës Publike. Këto procese, ashti si e theksuam edhe më sipër, monitorohen nga Komisioneri nëpërmjet një procesi që kryhet pranë Departamentit të Administratës Publike, në përfundim të të cilit, hartohet një raport vlerësimi.

Ndërsa, procedura e lëvizjes paralele, e cila zhvillohet në institucion, konstatohet se **është realizuar në përputhje me rregullat** dhe elementët kryesorë proceduralë të përcaktuar në nenin 25, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; kreun VII, të VKM nr. 243, dt. 18.3.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar dhe kreun II, të udhëzimit nr. 2, dt. 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”.

## **5. Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës, detyrimet e nëpunësit dhe procedura e vendimmarrjes në përfundim të kësaj periudhe.**

Nëpunësit civil, që emërohen për herë të parë në shërbimin civil i nënshtrohen një periudhë prove. Afati i periudhës së provës si dhe detyrat që duhet të përmbushë nëpunësi civil dhe institucioni përgjatë kësaj periudhe dhe në përfundim të saj, janë të përcaktuara në nenin 24, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; në Kreun V, të vendimit nr. 143, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civil të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”, (për të gjitha ato procedura që kanë filluar gjatë

*kohës që ka qenë në fuqi kjo VKM); si dhe në Kreun VI, të vendimit nr. 243, datë 18.03.2015 i ndryshuar, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”.*

Në mbështetje të këtyre dispozitave ligjore, nëpunësi në periudhë prove është i detyruar të ndjekë programin e detyrueshëm të trajnimit për periudhën e provës pranë ASPA-s dhe udhëzimet e nëpunësit më të vjetër civil, nën kujdesin e të cilit ai është vendosur.

Eprori direkt i nëpunësit në periudhë prove, duhet të caktojë nëpunësin më të vjetër nën kujdesin e të cilit do të vendoset nëpunësi civil në periudhë prove, të bëjë vlerësimin e rezultateve individuale në punë për periudhën e provës dhe të nxjerrë vendimin për përfundimin e periudhës së provës.

Në zbatim të planit të mbikëqyrjes, u verifikuan në tërësi veprimet të kryera për konfirmimin e nëpunësve civile, të cilët i janë nënshtruar periudhës së provës dhe që aktualisht vazhdojnë marrëdhënien e punësimit me institucionin.

Gjatë procesit të verifikimit u konstatua se, në institucionin e ISHPSHSH-së, në momentin e realizimit të mbikëqyrjes për periudhën Janar 2020 – Tetor 2023, rezultoi se, për **24** nëpunës ka përfunduar periudha e provës dhe janë konfirmuar nëpunës civilë, për **2** nëpunës Kryeinspektori Rajonal në ISHPSHSH Korçë ka shtyrë afatin e vlerësimit në përfundim të periudhës së provës me gjashtë muaj një herë të vetme, ndërsa për **1** nëpunës periudha e provës mbaron me datë 11.01.2024.

*Për periudhën objekt mbikëqyrje, janë deklaruar nëpunës civil në përfundim të periudhës së provës **24** nëpunës:*

- ✓ \*\*\*\*\* emëruar me aktin nr. 5033 prot., datë 30.08.2022 nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Inspektor*” në Sektorin e Mbikëqyrjes së Sigurisë dhe Shëndetit në Punë. Në përfundim të periudhës së provës, me aktin nr. 4667/1 prot., datë 20.09.2023, të DAP, është deklaruar nëpunës civil në pozicionin “*Inspektor*” në Sektorin e Mbikëqyrjes së Sigurisë dhe Shëndetit në Punë;
- ✓ \*\*\*\*\* emëruar me aktin nr. 4915 prot., datë 16.08.2022 nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Inspektor*” në Drejtorinë Rajonale të ISHPSHSH-së, Tiranë, Rajoni i Sektorit të Inspektimit Tiranë.  
Në përfundim të periudhës së provës, me aktin nr. 4850/1 prot., datë 03.10.2023, të DAP, është deklaruar nëpunës civil në pozicionin “*Inspektor*” në Drejtorinë Rajonale të ISHPSHSH-së, Tiranë, Rajoni i Sektorit të Inspektimit Tiranë;
- ✓ \*\*\*\*\* emëruar me aktin nr. 4912 prot., datë 16.08.2022 nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Inspektor*” në Drejtorinë Rajonale të ISHPSHSH-së, Tiranë, Rajoni i Sektorit të Inspektimit Tiranë.  
Në përfundim të periudhës së provës, me aktin nr. 4852/1 prot., datë 29.09.2023, të DAP, është deklaruar nëpunës civil në pozicionin “*Inspektor*” në Drejtorinë Rajonale të ISHPSHSH-së, Tiranë, Rajoni i Sektorit të Inspektimit Tiranë;

- ✓ \*\*\*\*\* emëruar me aktin nr. 4911 prot., datë 16.08.2022 nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Inspektor*” në Drejtorinë Rajonale të ISHPSHSH-së, Tiranë, Rajoni i Sektorit të Inspektimit Tiranë.  
Në përfundim të periudhës së provës, me aktin nr. 4851/1 prot., datë 29.09.2023, të DAP, është deklaruar nëpunës civil në pozicionin “*Inspektor*”, në Drejtorinë Rajonale të ISHPSHSH-së, Tiranë, Rajoni i Sektorit të Inspektimit Tiranë;
- ✓ \*\*\*\*\* emëruar me aktin nr. 4914 prot., datë 16.08.2022 nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Inspektor*” në Drejtorinë Rajonale të ISHPSHSH-së, Gjirokastrë, Rajoni VI Sektori i Inspektimit Gjirokastrë.  
Në përfundim të periudhës së provës, me aktin nr. 4870/1 prot., datë 03.10.2023, të DAP, është deklaruar nëpunës civil në pozicionin “*Inspektor*” në Drejtorinë Rajonale të ISHPSHSH-së, Gjirokastrë, Rajoni VI Sektori i Inspektimit Gjirokastrë;
- ✓ \*\*\*\*\* emëruar me aktin nr. 5033 prot., datë 30.08.2022, nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Inspektor*” në Drejtorinë e Inspektimit të Punës Sektori i Mbikëqyrjes së Marrëdhënieve të Punës.  
Në përfundim të periudhës së provës, me aktin nr. 4666/1 prot., datë 20.09.2023, të DAP, është deklaruar nëpunës civil në pozicionin “*Inspektor*” në Drejtorinë e Inspektimit të Punës Sektori i Mbikëqyrjes së Marrëdhënieve të Punës;
- ✓ \*\*\*\*\* emëruar me aktin nr. 5927 prot., datë 17.11.2020 nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Inspektor*” në Degën Rajonale Durrës. Në përfundim të periudhës së provës, me aktin nr. 4587/1 prot., datë 19.09.2023, të DAP, është deklaruar nëpunës civil në pozicionin “*Inspektor*”, në Drejtorinë Rajonale të ISHPSHSH-së, Tiranë, Rajoni I, Sektori i Inspektimit Durrës;
- ✓ \*\*\*\*\* emëruar me aktin nr. 4913 prot., datë 16.08.2022 nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Inspektor*” në Drejtorinë Rajonale të ISHPSHSH-së, Shkodër, Rajoni V, Sektori i Inspektimit Lezhë. Në përfundim të periudhës së provës, me aktin nr. 4433/1 prot., date 20.09.2023, të DAP, është deklaruar nëpunës civil në pozicionin “*Inspektor*” në Drejtorinë Rajonale të ISHPSHSH-së, Shkodër, Rajoni V Sektori i Inspektimit Lezhë;
- ✓ \*\*\*\*\* emëruar me aktin nr. 4913 prot., datë 16.08.2022 nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Specialist*” në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Përgjithshme, Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse. Në përfundim të periudhës së provës, me aktin nr. 3439/1 prot., datë 07.07.2023, të DAP, është deklaruar nëpunës civil në pozicionin “*Specialist*” në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Përgjithshme, Drejtorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse;
- ✓ \*\*\*\*\* emëruar me aktin nr. 969 prot., datë 12.02.2019 nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Specialist*” në Drejtorinë e Inspektimit të Punës, Sektori i Mbikëqyrjes së Marrëdhënieve të Punës. Në përfundim të periudhës së provës, me aktin nr. 2216/1 prot., datë 04.06.2020, të DAP, deklaruar nëpunës civil në pozicionin “*Inspektor*” në Drejtorinë e Inspektimit të Punës, Sektori i Mbikëqyrjes së Marrëdhënieve të Punës;
- ✓ \*\*\*\*\* emëruar me aktin nr. 5089 prot., datë 19.10.2020 nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Inspektor*” në Drejtorinë Rajonale të ISHPSHSH-së, Gjirokastrë, Rajoni VI, Sektori i Inspektimit Gjirokastrë. Në përfundim të periudhës së provës, me



- aktin nr. 6552/1 prot., datë 14.12.2021, të DAP, është deklaruar nëpunës civil në pozicionin “*Inspektor*” në Drejtorinë Rajonale të ISHPSHSH-së, Gjirokastrë, Rajoni VI, Sektori i Inspektimit Gjirokastrë;
- ✓ \*\*\*\*\* emëruar me aktin nr. 994 prot., datë 13.02.2020 nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Inspektor*”, në Drejtorinë Rajonale të ISHPSHSH-së, Gjirokastrë, Rajoni VI, Sektori i Inspektimit Gjirokastrë. Në përfundim të periudhës së provës, me aktin nr. 2490/1 prot., datë 20.04.2021, të DAP, është deklaruar nëpunës civil në pozicionin “*Inspektor*” në Drejtorinë Rajonale të ISHPSHSH-së, Gjirokastrë, Rajoni VI, Sektori i Inspektimit Gjirokastrë;
  - ✓ \*\*\*\*\* emëruar me aktin nr. 499/6 datë 17.02.2020 nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Inspektor*” në Drejtorinë Rajonale të ISHPSHSH-së, Gjirokastrë, Rajoni VI Sektori i Inspektimit Sarandë. Në përfundim të periudhës së provës, me aktin nr. 2492/1 prot., datë 19.04.2021, të DAP, është deklaruar nëpunës civil në pozicionin “*Inspektor*” në Drejtorinë Rajonale të ISHPSHSH-së, Gjirokastrë, Rajoni VI, Sektori i Inspektimit Sarandë;
  - ✓ \*\*\*\*\* emëruar me aktin nr. 997 prot., datë 13.02.2020 nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Inspektor*” në Drejtorinë Rajonale të ISHPSHSH-së, Dibër, Rajoni III, Sektori i Inspektimit Dibër. Në përfundim të periudhës së provës, me aktin nr. 4729/1 prot., datë 07.09.2021, të DAP, është deklaruar nëpunës civil në pozicionin “*Inspektor*” në Drejtorinë Rajonale të ISHPSHSH-së, Dibër, Rajoni III, Sektori i Inspektimit Dibër;
  - ✓ \*\*\*\*\* emëruar me aktin nr. 5498 prot., datë 04.10.2021 nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Inspektor*” në Drejtorinë e Inspektimit të Punës, Sektori i Analizës së Riskut. Në përfundim të periudhës së provës, me aktin nr. 6807/1 prot., datë 30.12.2022, të DAP, është deklaruar nëpunës civil në pozicionin “*Inspektor*” në Drejtorinë e Inspektimit të Punës, Sektori i Analizës së Riskut;
  - ✓ \*\*\*\*\* emëruar me aktin nr. 5499 prot., datë 04.10.2021 nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Inspektor*” në Drejtorinë e Inspektimit të Punës, Sektori i Statistikës. Në përfundim të periudhës së provës, me aktin nr. 6808/1 prot., datë 27.12.2022, të DAP, është deklaruar nëpunës civil në pozicionin “*Inspektor*” në Drejtorinë e Inspektimit të Punës, Sektori i Statistikës;
  - ✓ \*\*\*\*\* emëruar me aktin nr. 5499 prot., datë 04.10.2021 nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Specialist*” në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Përgjithshme. Në përfundim të periudhës së provës, me aktin nr.1465/1 prot., datë 19.07.2022, të DAP është deklaruar nëpunës civil në pozicionin “*Specialist*” në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Përgjithshme;
  - ✓ \*\*\*\*\* emëruar me aktin nr. 656 prot., datë 31.01.2022 nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Specialist*” në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Përgjithshme. Në përfundim të periudhës së provës, me aktin nr.1688/1 prot., datë 03.04.2023, të DAP, është deklaruar nëpunës civil në pozicionin “*Specialist*” në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Përgjithshme;

- ✓ \*\*\*\*\* emëruar me aktin nr.5951 prot., datë 17.11.2020 nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Inspektor*” në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, Sektori i Çështjeve Ligjore. Në përfundim të periudhës së provës, me aktin nr.2598 prot., datë 23.11.2021, të DAP, është deklaruar nëpunës civil në pozicionin “*Inspektor*” në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, Sektori i Çështjeve Ligjore;
- ✓ \*\*\*\*\* emëruar me aktin nr. 634 prot., datë 26.01.2021 nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Kryeinspektor*” në Drejtorinë Rajonale të ISHPSHSH-së, Tiranë, Rajoni I, Sektori i Inspektimit Durrës. Në përfundim të periudhës së provës, me aktin nr.1960/1 prot., datë 30.03.2022, të DAP, është deklaruar nëpunës civil në pozicionin “*Përgjegjës Sektori*” në Drejtorinë Rajonale të ISHPSHSH-së, Tiranë, Rajoni I, Sektori i Inspektimit Durrës;
- ✓ \*\*\*\*\* emëruar me aktin nr. 634 prot., datë 26.01.2021 nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Inspektor*” në Degën Rajonale Durrës. Në përfundim të periudhës së provës, me aktin nr.2494/1 prot., datë 19.04.2021, të DAP, është deklaruar nëpunës civil në pozicionin “*Inspektor*” në Drejtorinë Rajonale të ISHPSHSH-së, Tiranë, Rajoni I, Sektori i Inspektimit Durrës;
- ✓ \*\*\*\*\* emëruar me aktin nr. 962 prot., datë 12.02.2019 nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Inspektor*” në Degën Rajonale Berat. Në përfundim të periudhës së provës, me aktin nr. 2418/1 prot., datë 15.06.2020, të DAP, është deklaruar nëpunës civil në pozicionin “*Inspektor*” Drejtorinë Rajonale të ISHPSHSH-së, Vlorë, Rajoni II, Sektori i Inspektimit Berat;
- ✓ \*\*\*\*\* emëruar me aktin nr. 825 prot., datë 02.02.2021 nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Kryeinspektor*” në Degën Rajonale Kukës. Në përfundim të periudhës së provës, me aktin nr. 1959/1 prot., datë 14.04.2022, të DAP, është deklaruar nëpunës civil në pozicionin “*Përgjegjës Sektori*” në Drejtorinë Rajonale të ISHPSHSH-së, Dibër, Rajoni III, Sektori i Inspektimit Kukës;
- ✓ \*\*\*\*\* emëruar me aktin nr. 499/9 prot., datë 17.02.2020 nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Inspektor*” në Degën Rajonale Elbasan. Në përfundim të periudhës së provës, me aktin nr. 2493/1 prot., datë 20.04.2021, të DAP, është deklaruar nëpunës civil në pozicionin “*Inspektor*” në Drejtorinë Rajonale të ISHPSHSH-së, Korçë, Rajoni IV Sektori i Inspektimit Elbasan.

Për të gjitha rastet e mësipërme, u verifikua përmbushja e kërkesave ligjore të periudhës së provës në bazë të të cilave, nëpunësi civil, është i detyruar që:

- ✓ të kryejë ciklin e detyrueshëm të trajnimit pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASP) dhe
- ✓ të ndjekë udhëzimet e nëpunësit më të vjetër, nën kujdesin e të cilit ai është i vendosur.

Nga këqyrja e akteve, rezulton se, në përfundim të periudhës së provës, bazuar në rezultatet e testimit në ASPA dhe në vlerësimin e rezultateve individuale në punë, të cilat janë kryer, për

këta nëpunës, eprori direkt, ka vendosur konfirmimin si nëpunës civilë në pozicionet përkatëse.

Konstatohet se, në disa raste, mungon mendimi me shkrim i nëpunësit civil më të vjetër në detyrë, udhëzimet e të cilit duhet të ndjekë nëpunësi civil në periudhë prove, detyrim që rrjedh nga pika 2/b dhe pika 4, e Kreut VI, të vendimit nr. 243, datë 18.3.2015 i ndryshuar, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”.

Përmendim faktin se, formularët e vlerësimit të rezultateve në punë, në fund të periudhës së provës, për këta nëpunës, janë kryer sipas Lidhjes nr. 2, bashkëlidhur Vendimit nr.109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar dhe janë nënshkruar nga nëpunësit e përfshirë në procesin e vlerësimit të rezultateve në punë siç janë, Zyrtari Raportues, Zyrtari Kundërfirmues dhe Zyrtari Autorizues, dhe ky vlerësim është kryer për një periudhë një vjeçare, ashtu si e parashikon pika 2 e Kreut II, të Vendimit nr.109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar.

**Konstatim:** Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se, për nëpunësen Serenela Matuka emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 5927 datë 17.11.2020, në pozicionin e punës “Inspektor” në Degën Rajonale Durrës, e në vijim, për shkak të ristrukturimit të institucionit, me aktin nr. 992/45 prot., datë 10.02.2021, është transferuar në poizicionin aktual, periudha e provës ka përfunduar në vitin 2022. Kjo situatë ka ndodhur për faktin se, fillimisht kjo nëpunëse për gjatë periudhës 2020/2021, ka qenë vazhdimisht me raport mjekësor. Nisur nga kjo situatë, me vendimin nr.1 datë 18.02.2021, “Për kohëzgjatjen e periudhës së provës”, të eprorit të saj direkt, i është shtyrë vlerësimi rezultateve në punë për një periudhë një vjeçare. Në përfundim të kësaj periudhe, pra në datën 18.02.2022 nëpunësja, ka qenë me lejen e barrëlindjes dhe është rikthyer në punë në muajin Gusht të vitit 2022. Pas pas rikthimit në punë është bërë i mundur vlerësimi një vjeçar, në përfundim të periudhës së provës dhe është deklaruar nëpunëse civile, me aktin nr.4587/1, datë 19.09.2023, të DAP në pozicionin aktual, “Inspektor” në degën rajonale Durrës.

✓ Nëpunës civil të cilët vazhdojnë periudhën e provës.

Konstatohet se, në momentin e kryerjes së mbikëqytjes, janë **3** nëpunës civilë, të cilët vazhdojnë periudhën e provës:

- \*\*\*\*\*, është emëruar nëpunëse civile në periudhë prove, me aktin nr.6846/4 prot., datë 06.01.2023, të DAP, në pozicionin “Inspektor”, Sektori i Inspektimit Sarandë, në Drejtorinë Rajonale të ISHPSHSH-së, Gjirokastër, Rajoni VI.
- \*\*\*\*\*, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove me aktin nr. 4910 prot., datë 16.08.2022, të DAP, në pozicionin “Inspektor” Rajoni i Sektorit të Inspektimit Durrës, në Drejtorinë Rajonale të ISHPSHSH-së, Tiranë. Ky nëpunës e ka kryer me sukses trajnimin e detyrueshëm pranë ASPA-s. Me vendimin nr. 4315 prot., datë

14.09.2023, të Kryeinspektorit Rajonal të ISHPSHSH-së Tiranë, ka vendosur shtyrjen e afatit të vlerësimit në përfundim të periudhës së provës me gjashtë muaj, bazuar në VKM-në nr. 243/205, Kreu VI, pika 7, germa “b” zgjatjen një herë të vetme deri në 6 (gjashtë) muaj të periudhës së provës, në rastin kur eprorit i nevojitet më shumë kohë për të vlerësuar nëpunësin.

- \*\*\*\*\*, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove me aktin nr. 4909 prot., datë 16.08.2022, të DAP, në pozicionin “Inspektor” Rajoni IV Sektori i Inspektimit Korçë, në Drejtorinë Rajonale të ISHPSHSH-së, Korçë. Ky nëpunës e ka kryer me sukses trajnimin e detyrueshëm pranë ASPA-s. Me vendimin nr. 1533 prot., datë 20.09.2023 të Kryeinspektorit Rajonal të ISHPSHSH-së Korçë, ka vendosur shtyrjen e afatit të vlerësimit në përfundim të periudhës së provës me gjashtë muaj.

**Konkluzion:** Nga sa analizuam më sipër, Komisioneri vlerëson se, procedura e vendimmarrjes në fund të periudhës së provës nga eprori direkt, duke i konfirmuar nëpunës civilë, punonjësit e këtij institucioni, përgjithësisht është kryer në përputhje me kërkesat e ligjit, por, nga ana tjetër, konstatohet se për disa punonjës, në mbarim të periudhës së provës, **mungon mendimi me shkrim i nëpunësit civil më të vjetër**, ky është një detyrim ligjor që eprori direkt dhe njësia përgjegjëse duhet ta ketë në vëmendje për ta zbatuar në vijimësi. Kjo parregullsi, është e një natyre që nuk e cënon thelbin e procesit të konfirmimit, e për këtë arsye procedura do të vlerësohet si e realizuar, por, njësia përgjegjëse dhe eprorët direkt, duhet të tregojnë kujdes, që në të ardhmen, në praktikën e konfirmimit të nëpunësit në përfundim të periudhës së provës, të mos lejojë të tilla raste. Eprori direkt i nëpunësit, duhet të caktojë punonjësin që do të mbikëqyrë nëpunësin në periudhë prove dhe para se të nxjerrë vendimin e arsyetuar të konfirmimit, krahas vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën e provës dhe çertifikatës së trajnimit të detyrueshëm pranë ASPA-s, duhet të administrojë edhe mendimin e nëpunësit më të vjetër, nën kujdesin e të cilit është vendosur nëpunësi civil në periudhë prove.

## **6. Transferimi i përkohshëm dhe transferimi i përhershëm dhe si janë respektuar kërkesat ligjore në këto raste, (ristrukturimi, ngritja e komisionit përkatës, aktet që materializojnë procesin si dhe rastet e tjera të transferimit).**

Kriteret bazë mbi të cilat duhet të bëhet vlerësimi i ligjshmërisë së procesit të transferimit të nëpunësit civil në një pozicion tjetër të shërbimit civil, (*transferimi i përkohshëm, arsyet e transferimit, kohëzgjatja e transferimit, transferimi i përhershëm, rastet kur zbatohet transferimi i përhershëm, transferimi në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit*), janë përcaktimet e kreut VIII “*Transferimi në shërbimin civil*”, nenet nga 48 deri në 52, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”, vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar, si dhe udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “*Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit*”, i ndryshuar.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes në institucionin e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, u konstatua se, për periudhën objekt mbikëqyrje (*Janar 2020 - Korrik 2023*), në këtë institucion janë kryer një numër i konsiderueshëm transferimesh, të cilat, referuar dispozitave që rregullojnë këtë institut të ligjit nr. 152/2013, kategorizohen si më poshtë:

- **126** raste transferimi të përhershëm për shkak të ristrukturimit të institucionit, të parashikuar nga neni 50 i ligjit;
- **1** rast transferimi i përhershëm për arsye të paaftësisë shëndetësore, rregulluar në nenin 51 të ligjit;
- **1** rast transferimi të përhershëm për shmangien e konfliktit të interesit, parashikuar nga neni 52 i ligjit.

Ndërsa, transferimi në përfundim të afatit apo zhdukjes së shkakut të pezullimit nëse pozicioni i mëparshëm i punës është plotësuar përfundimisht, të parashikuar nga pika 1, e nenit 56, të ligjit, për periudhën e mbikëqyrur nuk është aplikuar në asnjë rast.

- ✓ ***Transferimi për shkak të ristrukturimit të institucionit, apo ndryshimit të mënyrës së organizimit të institucionit:***

Nga verifikimi i tërësisë së materialeve shkresore të vëna në dispozicion, si dhe vlerësimit të tyre në raport me ligjin, vëmë re, se me urdhrin nr. 156, datë 24.11.2020, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore”, është miratuar struktura dhe organika e re e institucionit. Në vijim të këtij urdhri, është përcaktuar numri i punonjësve të këtij institucioni për nivelin qendror si dhe 6 drejtoritë rajonale që ka në varësi, detajuar sipas skemave bashkëlidhur urdhrin. Gjithashtu, urdhri për miratimin e strukturës së re, ka shfuqizuar strukturën dhe organikën e mëparshme të institucionit, të miratuar me urdhrin nr. 1, datë 7.1.2014, të Kryeministrit.

Gjatë harkut kohor 2014 - 2018, struktura ka pësuar disa ndryshime, fillimisht me urdhrin nr. 96, datë 7.6.2016, është shkurtuar një pozicion pune i nivelit “*specialist*” dhe është shtuar një pozicion pune në sektorin mbështetës administrativ, “*sekretar*”, e më tej, me urdhrin nr. 116, datë 31.7.2018, është zvogëluar numri i punonjësve në nivel qendror, nga 38 në 36 dhe në total, sipas këtij urdhri përfundimisht ISHPSHSH ka pasur **154** punonjës gjithsej.

Duke krahasuar strukturën e mëparshme me strukturën pasardhëse të institucionit, rezulton se numri i përgjithshëm i vendeve të punës ka qenë 154 dhe është bërë 165, pra janë shtuar **11** vende pune, nga të cilat 10 prej tyre janë pozicione që përfshihen në shërbimin civil.

E shprehur në formë tabelare, situata paraqitet në vijim:

Tabela nr.1: Situata e pozicioneve të punës para ristrukturimit

Emërtesa e pozicionit sipas organikës dhe kategorisë në shërbimin civil	Numri i punonjësve sipas organikës së miratur me urdhrin nr. 116/2018 (i cili ka ndryshuar urdhrin nr. 1/2014)
<b>Kategoria e mesme drejtuese</b> Drejtor, Drejtorja e Inspektimit	<b>1</b>
<b>Kategoria ekzekutive</b> Kryeinspektor Rajonal/ Përgjegjës Sektori/Rajonal/ Inspektor/ Specialist	<b>143</b>
<b>Funksione mbështetëse dhe titullari</b>	10
Totali	(144 pozicione në shërbimin civil +10 funksione mbështetëse) <b>154</b>

Tabela nr. 2: Situata e pozicioneve të punës pas ristrukturimit

Emërtesa e pozicionit sipas organikës dhe kategorisë në shërbimin civil	Numri i punonjësve sipas organikës së miratur me urdhrin nr. 156/2020
<b>Kategoria e mesme drejtuese</b> Zëvendës Kryeinspektor/Koordinator	<b>1</b>
<b>Kategoria e ulët drejtuese</b> Drejtor Drejtorie	<b>2</b>
<b>Kategoria ekzekutive</b> Drejtor Drejtorie Rajonal/Përgjegjës sektori/Përgjegjës sektori rajonal/ Kryeinspektor Rajonal/Inspektor/specialist	<b>150</b>
<b>Funksione mbështetëse dhe titullari</b>	12
Totali	(153 pozicione në shërbimin civil +12 funksione mbështetëse) <b>165</b>

**Shënim:** Në kushtet kur subjekti i mbikëqyrjes është institucion varësie, terminologjia e përdorur në strukturë për ndarjen e funksioneve në njësitë organizative, ka kuptim në drejtim të hierarkisë administrative të tyre dhe jo në kuptim të nenit 19, të ligjit për nëpunësin civil, i cili në këtë rast, materializohet në kategorinë e pagës për çdo pozicion pune dhe paraqitet në këto tabela.

Kjo situatë tashmë është rregulluar me aktin e ri nënligjor që rregullon kategorizimin e pagave në shërbimin civil.

✓ **Ristrukturimi i institucionit të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.**

Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse për këtë rast, është subjekti i cili drejton të gjithë procesin e ristrukturimit, duke respektuar të gjitha etapat që kërkon ky proces.

Nga trajtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, si dhe vlerësimit të tij në raport me kërkesat e ligjit, rezulton të jenë marra masat si më poshtë, të cilat i referohen fazave përkatëse procedurale në të cilat kalon ky proces:

- *Njoftimi për fillimin e procedurës së ristrukturimit*

Në zbatim të pikës 7, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe pikës 15, të vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, rezulton se punonjësit **janë njoftuar** individualisht nëpërmjet postës elektronike (e-mail) si dhe nëpërmjet shkresës zyrtare.

- *Krijimi i Komisionit të Ristrukturimit.*

Pas hyrjes në fuqi të strukturës dhe organikës së re, Departamenti i Administratës Publike, me urdhrin nr. 86 prot., datë 2.12.2020, i ndryshuar me urdhrin nr. 2, datë 12.1.2021, **ka ngritur Komisionin e Ristrukturimit** pranë Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore të përbërë nga:

- \*\*\*\*\* , “Specialist” në Sektorin e Sekretariatit Teknik për TND-në dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Procedurave të Rekrutimit në Shërbimin Civil, Departamenti i Administratës Publike – Kryetar
- \*\*\*\*\* , “Sekretar i Përgjithshëm” i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë – anëtar;
- \*\*\*\*\* , “Kryeinspektor” i Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore – anëtar.

**Konkluzion:** Nga sa analizuar më sipër, Komisioneri vlerëson se, Komisioni i Ristrukturimit **është krijuar në përputhje me kërkesat e ligjit**, përcaktuar në pikat 3 e 4, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; pikat 16 e 17, të kreut II, të vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, si dhe udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit, për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”, i ndryshuar.

- *Propozimi i Komisionit të Ristrukturimit për transferimin e nëpunësve civilë për shkak të ristrukturimit.*

Komisioni i Ristrukturimit, pasi ka analizuar organikën e vjetër dhe organikën e re të institucionit, ka evidentuar pozicionet e punës të cilat prekeshin nga restrukturimi, si dhe nëpunësit e punësuar në këto pozicione. Më pas, është vijuar me verifikimin e plotësisimit të kërkesave të posaçme të parashikuara për çdo pozicion të lirë apo të krijuar me të dhënat individuale të nëpunësve në pritje për transferim.

Vendimet propozuese të Komisionit të Ristrukturimit për transferimin e nëpunësve civilë për shkak të restrukturimit janë pasqyruar në shkresën nr. 292 prot., dt. 09.02.2021, “*Vendim i Komisionit të Ristrukturimit të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore për propozimin e transferimit të përhershëm të nëpunësve civilë, në kuadër të restrukturimit*”.

Në përfundim të procedurave të verifikimit, Komisioni ka vendosur si më poshtë:

- Për **117**, nëpunës është propozuar transferimi në pozicione pune të së njëjtës kategori (për 5 prej tyre ka ndryshuar klasa e pagës nga IV-b në IV-a dhe emërtesa nga “Specialist” në “Inspektor”; ndërsa për 1 nëpunëse kategoria e pagës ka ndryshuar nga IV-a në III-b).

Në këtë rast, Komisioni i Ristrukturimit, **ka vepruar në përputhje me parashikimet e ligjit**, përcaktuar në pikën 1, të nenit 50, të ligjit: “Nëse për shkak të mbylljes apo restrukturimit të institucionit, pozicioni i mëparshëm i një nëpunësi civil nuk ekziston më, ai transferohet në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori”.

- Për **8**, nëpunës është propozuar transferimi në pozicione pune të një kategorie më të ulët. Në këtë rast bëhet fjalë për nëpunësit:
  - \*\*\*\*\* , “Përgjegjës i Sektorit të Inspektimit”, kategoria e pagës IV-a, është propozuar të transferohet në pozicionin “Inspektor në Sektorin e Inspektimit Tiranë”, kategoria e pagës IV-b;
  - \*\*\*\*\* , “Përgjegjës i Sektorit të Inspektimit”, kategoria e pagës IV-a, është propozuar të transferohet në pozicionin “Inspektor në Sektorin e Inspektimit Tiranë”, kategoria e pagës IV-b;
  - \*\*\*\*\* , “Përgjegjës i Sektorit të Inspektimit”, kategoria e pagës IV-a, është propozuar të transferohet në pozicionin “Inspektor në Sektorin e Inspektimit Tiranë”, kategoria e pagës IV-b;
  - \*\*\*\*\* , “Përgjegjës i Sektorit të Inspektimit”, kategoria e pagës IV-a, është propozuar të transferohet në pozicionin “Inspektor në Sektorin e Inspektimit Tiranë”, kategoria e pagës IV-b;
  - \*\*\*\*\* , “Kryeinspektor i Degës Rajonale Durrës”, kategoria e pagës III-b, është propozuar të transferohet në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Inspektimit Durrës”, kategoria e pagës IV-a;



- \*\*\*\*\* , “Kryeinspektor i Degës Rajonale Fier”, kategoria e pagës III-b, është propozuar të transferohet në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Inspektimit Fier”, kategoria e pagës IV-a;
- \*\*\*\*\* , “Kryeinspektor i Degës Rajonale Kukës”, kategoria e pagës III-b, është propozuar të transferohet në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Inspektimit Kukës”, kategoria e pagës IV-a;
- \*\*\*\*\* , “Kryeinspektor i Degës Rajonale Elbasan”, kategoria e pagës III-b, është propozuar të transferohet në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Inspektimit Kukës”, kategoria e pagës IV-a.

Duke analizuar materialin propozues të Komisionit të Ristrukturimit, vihet re se, sistemimi i këtyre punonjësve në pozicione të shërbimit civil të një niveli më të ulët, është bërë me arsyetimin se, poizicioni “Kryeinspektor”, kategoria III-b, është shkurtuar.

Në këtë rast, Komisioni i Ristrukturimit ka marrë miratimin me shkrim të nëpunësve, ku ata janë shprehur, se e pranojnë transferimin e përhershëm në një pozicion të një kategorie më të ulët, për shkak të mbylljes apo ristrukturimit.

Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, pasi ka marrë në shqyrtim propozimet e bëra nga Komisioni, me shkresën nr. 992/1 prot., datë 10.2.2021, “Mbi transferimin e përhershëm të nëpunësve në kuadër të ristrukturimit të Inspektoratit të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore”, ka miratuar propozimet e bëra prej tij. Më tej, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore e institucionit, i ka njoftuar çdo nëpunësi vendimin përfundimtar të transferimit, të marrë nga njësia përgjegjëse.

(Vendimet përfundimtare të marra nga Departamenti i Administratës Publike, për transferimin e nëpunësve për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit, janë të evidentuara në tabelën nr. 1: “Nëpunës të punësuar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes, në institucionin e ISHPSHSH-së”, që i bashkëlidhet raportit si pjesë e tij).

- Raste të përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, për shkak të ristrukturimit të institucionit.

Nga verifikimet e kryera rezulton se, Komisioni i Ristrukturimit të ISHPSHSH-së, ka vendosur në një rast të vetëm përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ristrukturimit të institucionit.

Me miratimin e strukturës së re të Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Drejtoria e Inspektimit për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë dhe Drejtoria e Inspektimit për Marrëdhëniet e Punës dhe Statistikën, janë bashkuar dhe drejtoria e re është emërtuar Drejtoria e Inspektimit të Punës, kategoria II-b.

Referuar pikës 1, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar nëse për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, pozicioni i mëparshëm i një nëpunësi civil nuk ekziston më, ai transferohet në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori.

Mbështetur në pikën 2, gërmat c dhe ç të nenit 50, Komisioni i Ristrukturimit ka shqyrtuar mundësinë e sistemimit në institucionet e tjera të shërbimit civil, referuar listës së pozicioneve vakante me kriteret përkatëse që u vendos në dispozicion nga Departamenti i Administratës Publike, dhe ka konstatuar se nuk ka pasur vende vakante të së njëjtës kategori në institucione të tjera të shërbimit civil në të cilat nëpunësi plotësonte kriteret e veçanta, për sa më sipër edhe transferimi në një institucion tjetër në shërbimin civil nuk mund të kryhej.

Me vendimin nr. 293 prot., datë 9.2.2021, të Komisionit të Ristrukturimit është liruar nga shërbimi civil nëpunësi \*\*\*\*\*, me detyrë “Drejtor në Drejtorinë e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë”, kategoria III-a.

Nëpunësit të liruar nga shërbimi civil, në përputhje me eksperiencën në punë si nëpunës civil, i është njohur e drejta e dëmshpërblimit sipas përcaktimeve të pikës 7, shkronja “b”, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Nëpunësi \*\*\*\*\*, i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe pranë kësaj gjykate është regjistruar për gjykim çështja administrative me objekt: Anulimin e Vendimit nr. 28, date 12.02.202, të Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore “Për lirim nga shërbimi civil” dhe anulimin e vendimit nr. 293 prot., datë 09.02.2021, të Komisionit të Ristrukturimit. Deri në momentin e mbikëqyrjes kjo çështja ishte ende në shqyrtim pranë Gjykatës së Apelit. Në këto kushte, referuar parimit të sanksionuar në nenin 36, të ligjit nr. 8116, dt. 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile”, i ndryshuar, sipas të cilit, institucionet e tjera shtetërore nuk mund të trajtojnë çështje që po trajtohen apo janë trajtuar nga sistemi gjyqësor, vlerësojmë se kjo çështje do të marrë zgjidhje përfundimtare pas përfundimit të procesit gjyqësor, ku do të vlerësohet situata.

✓ ***Transferimi i përhershëm për arsye të paaftësisë shëndetësore.***

Gjatë periudhës objekt mbikëqyrje janar 2020 - korrik 2023, Departamenti i Administratës Publike, në vijim të shkresave nr. 2417/1 prot., datë 5.11.2021 dhe nr. 42 prot., datë 7.1.2022, si dhe në zbatim të neneve 49 e 51, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Kreut III, të Vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, me aktin nr. 6059/4 prot., datë 2.2.2022, “Vendim për miratimin e transferimit të përhershëm për nëpunësin \*\*\*\*\*”, për shkak të gjendjes së paaftësisë shëndetësore për të kryer detyrat e pozicionit të mëparshëm, ka miratuar transferimin nga pozicioni “Përgjegjës” i Sektorit të Inspektimit Korçë, në Drejtorinë Rajonale të Inspektimit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Korçë, Rajoni IV, kategoria IV-a, në pozicionin “Përgjegjës” i Sektorit të Inspektimit Elbasan, në Drejtorinë Rajonale të Inspektimit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Korçë, Rajoni IV, kategoria IV-a.

✓ **Transferimi për shmangien e konfliktit të interesit.**

Gjatë vitit 2022, Departamenti i Administratës Publike, për nëpunësen Enkinela Kananaj, me aktin nr. 6347/4 prot., datë 19.12.2022, “Vendim për miratimin e transferimit të përhershëm”, ka miratuar transferimin e përhershëm për shkak të shmangies së konfliktit të vazhdueshëm të interesit, në zbatim të neneve 49 e 51, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Kreut III, të Vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”.

**Konkluzion:** Nga gjithë sa analizuam më sipër, Komisioneri vlerëson se nga ana e institucionit, subjekt i mbikëqyrjes, në të gjitha rastet e transferimeve të përhershme të evidentuara në këtë pjesë të materialit, janë respektuar të gjitha kërkesat e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për shërbimin civil në lidhje me këtë institut të ligjit.

**7. Pezullimi nga shërbimi civil, sipas rasteve të parashikuara në ligj, duke verifikuar se si janë zbatuar kërkesat ligjore për procedurat që janë zhvilluar në këto raste**

Pezullimi apo ndërprerja e përkohshme e marrëdhënies në shërbimin civil, (*arsyet kur një nëpunës civil pezullohet; pezullimi i nëpunësit civil me kërkesë të tij; pezullimi i nëpunësit civil në rastin e procedimit disiplinor, kur besohet se vazhdimi i detyrës pengon hetimin administrativ; si dhe, efektet e pezullimit*), janë të parashikuara në kreun IX, “Pezullimi nga shërbimi civil”, nenet nga 53 deri 56, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe vendimin nr. 124, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”, i ndryshuar.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, u verifikuan dosjet e nëpunësve që kanë paraqitur kërkesë për pezullimin e marrëdhënies në shërbimin civil, materialet shkresore që provojnë konstatimin e shkakut të ligjshëm të pezullimit nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore si dhe dokumentacionin që provon shkakun e ligjshëm të pezullimit apo arsyet e përmendura nga nëpunësi për të motivuar kërkesën për pezullim.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatuan 4 raste të pezullimit të marrëdhënies në shërbimin civil. Më konkretisht, bëhet fjalë për nëpunësit:

- \*\*\*\*\*\*, me detyrë “Inspektor”, në Drejtorinë Rajonale Elbasan, ka bërë kërkesën për pezullim nr. 859 prot., datë 26.05.2023. Si motivacion për pezullim, është përmendur punësimi në aktivitet privat, parashikuar nga shkronja “b”, pika 12, e VKM nr. 124, dt. 17.02.2016. Kërkesës i është bashkëngjitur kontrata e punës, për një afat të përcaktuar, tre muaj, e lidhur me subjektin një subjekt privat. Pas marrjes së kërkesës, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, me shkresën nr. 859/1 prot., datë 29.05.2023, “Vendim për pezullim nga shërbimi civil”, ka konstatuar dhe miratuar pezullimin e nëpunësit në fjalë për një periudhë 3 mujore, duke filluar ky afat që nga

data 01.06.2023. Akti i pezullimit i është njoftuar njësisë përgjegjëse DAP me shkresën nr.859/3 prot., datë 30.05.2023. Aktualisht është rikthyer në pozicionin e tij të mëpushëm të punës.

- \*\*\*\*\* me detyrë “*Inspektor pranë Kryeinspektorit*”, ka kërkuar pezullimin nëpërmjety shkresës nr. 148 prot., datë 20.01.2021. Si motivacion për pezullim, është përmendur punësimi në aktivitet privat, parashikuar nga shkronja “b”, pika 12, e VKM nr. 124, dt.17.02.2016. Kërkesës i është bashkëngjitur kontrata e punës, për një afat të përcaktuar, deri në dy vjet, e lidhur me një subjekt privat. Pas marrjes së kërkesës, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore me shkresën nr. 148/1 prot., datë 21.01.2021, “*Vendim për pezullim nga shërbimi civil*”, ka konstatuar dhe miratuar pezullimin e nëpunësit në fjalë për një periudhë deri në dy vjet, duke filluar ky afat që nga data 25.01.2021. Akti i pezullimit i është njoftuar njësisë përgjegjëse DAP me shkresën nr. 148/3 prot., datë 25.01.2021.
- \*\*\*\*\* me detyrë “*Përgjegjës në Sektorin e Inspektimit Kukës*”, ka bërë kërkesën për pezullim nr. 628 prot., datë 04.04.2023. Si motivacion për pezullim, është përmendur lejimi i ushtrimit të funksioneve zgjedhore, parashikuar në nenin 54/1, nga shkronja “d”, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar. Pas marrjes së kërkesës, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore me shkresën nr. 628/1 prot., datë 12.04.2023. “*Vendim për pezullim nga shërbimi civil*”, ka konstatuar dhe miratuar pezullimin e nëpunësit në fjalë për një periudhë nga regjistrimi si kandidat deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, duke filluar ky afat që nga data 14.04.2023. Akti i pezullimit i është njoftuar njësisë përgjegjëse DAP me shkresën nr. 2668/2 prot., datë 14.04.2023.
- \*\*\*\*\* me detyrë “*Inspektor*”, në Sektorin e Inspektimit Durrës, ka bërë kërkesën për pezullim me nr. 1397/1 prot., datë 04.09.2023. Si motivacion për pezullim, është përmendur punësimi në aktivitet privat, parashikuar nga shkronja “b”, pika 12, e VKM nr. 124, dt.17.2.2016. Kërkesës i është bashkëlidhur kontrata e punës, për një afat të përcaktuar, deri në dy vjet, e lidhur me subjektin privat. Pas marrjes së kërkesës, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore me shkresën nr.1397/2 prot., datë 04.09.2023, “*Vendim për pezullim nga shërbimi civil*”, ka konstatuar dhe miratuar pezullimin e nëpunëses në fjalë për një periudhë deri në dy vjet, duke filluar ky afat që nga data 04.09.2023. Akti i pezullimit i është njoftuar njësisë përgjegjëse DAP me shkresën nr. 1432/1 prot., datë 11.09.2023.

Referuar fakteve të përmendura si më lart rezulton se, në të gjitha rastet, nëpunësit kanë njoftuar njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore nëpërmjet kërkesës për pezullimin e marrëdhënies në shërbimin civil. Shkresës i janë bashkëlidhur dokumentet shkresore që vërtetojnë shkakun apo arsyen e pezullimit. Më pas, pezullimi nga shërbimi civil, është bërë me vendim të njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore. Për të gjitha vendimet e pezullimit nga shërbimi civil, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, ka vënë në dijeni njësinë përgjegjëse DAP.

**Konkluzion:** Në këtë rast, Komisioneri vlerëson se, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit të mbikëqyrur, në rastin e pezullimit të nëpunësve, **ka vepruar në përputhje me përcaktimet e ligjit** për nëpunësin civil dhe akteve nënligjore që rregullojnë këtë institut të ligjit.

## **8. Masat disiplinore dhe respektimi i procedurës ligjore të kërkuar në fazat e zhvillimit të ecurisë disiplinore, kërkesa për fillimin e ecurisë, ngritja e Komisionit të Përhershëm të Disiplinës.**

Instituti i disiplinës në shërbimin civil rregullohet në mënyrë të hollësishme në kreun X, “Disiplina në shërbimin civil”, në nenet 57 deri 61, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Në këtë kapitull përcaktohen në mënyrë specifike përgjegjësia për masat disiplinore, llojet e masave disiplinore, kompetencat dhe procedura për masat disiplinore, parimet për përshkallëzimin dhe individualizmin e masës disiplinore dhe shuarja e masës disiplinore.

Procedura e dhënies së masës disiplinore është përcaktuar në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në Vendimin nr. 115, datë 5.3.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil”, si dhe në Udhëzimin nr. 1, datë 2.4.2014, të Departamentit të Administratës Publike, “Për elementët kryesorë proceduralë dhe materialë të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”.

Sa i takon hapave të ndjekur gjatë ecurisë disiplinore nga ana e eprorit direkt apo Komisionit të Disiplinës, u konstatua se, në të gjitha rastet **janë respektuar** kërkesat e parashikuara në ligj dhe aktet nënligjore të sipërcituara, ashtu si është materializuar në procesverbalet e mbajtura nga grupi i mbikëqyrjes gjatë verifikimit të akteve administrative në subjekt. Në këtë rast u konstatua se **janë respektuar** të gjitha fazat e procesit dhe nëpunësve i **janë siguruar** të drejtat për tu dëgjuar dhe për tu mbrojtur gjatë ecurisë disiplinore.

Nga verifikimi i dokumentacionit, u konstatua se, në institucionin e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, për periudhën 2020-2023, ka pasur **25 raste** të aplikimit të masave disiplinore, të parashikuara në nenin 58, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të cilat janë evidentuar më poshtë, duke evidentuar edhe punonjësit që kanë qenë subjekt i tyre:

- \*\*\*\*\* , me detyrë “Inspektor në Elbasan”, me vendimin nr. 2544/1, datë 15.01.2020, të eprorit direkt, është marrë masa disiplinore “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen e shkallës e pagës për një periudhë 3 mujore”;
- \*\*\*\*\* , me detyrë “Inspektor në Drejtorinë Qëndrore”, me vendimin nr.2544/2, datë 15.01.2020, të eprorit direkt, është marrë masa disiplinore “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen e shkallës e pagës për një periudhë 12 mujore”;

- \*\*\*\*\*, me detyrë “Inspektor në Tiranë”, me vendimin nr. 1087/9, datë 19.06.2020, të eprorit direkt, është marrë masa disiplinore “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen e shkallës e pagës për një periudhë 12 mujore”;
- \*\*\*\*\*, me detyrë “Inspektor në Tiranë”, me vendimin nr. 1087/10, datë 19.06.2020, të eprorit direkt, është marrë masa disiplinore “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen e shkallës e pagës për një periudhë 3 mujore”;
- \*\*\*\*\*, me detyrë “Inspektor në Tiranë”, me vendimin nr. 1665/8, datë 18.09.2020, të eprorit direkt, është marrë masa disiplinore “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen e shkallës e pagës për një periudhë 12 mujore”;
- \*\*\*\*\*, me detyrë “Inspektor në Fier”, me vendimin nr. 2544/1, datë 24.06.2022, të eprorit direkt, është marrë masa disiplinore “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen e shkallës e pagës për një periudhë 2 vjecare”;
- \*\*\*\*\*, me detyrë “Inspektor në Elbasan”, me vendimin nr. 1101/8, datë 24.06.2022, të eprorit direkt, është marrë masa disiplinore “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen e shkallës e pagës për një periudhë 2 vjecare”;
- \*\*\*\*\*, me detyrë “Inspektor në Fier”, me vendimin nr. 1101/8, datë 24.06.2022, të eprorit direkt, është marrë masa disiplinore “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen e shkallës e pagës për një periudhë 2 vjecare”;
- \*\*\*\*\*, me detyrë “Inspektor në Elbasan”, me vendimin nr. 1101/9, datë 24.06.2022, të eprorit direkt, është marrë masa disiplinore “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen e shkallës e pagës për një periudhë 1 vjecare”;
- \*\*\*\*\*, me detyrë “Inspektor në Kukës”, me vendimin nr. 373, datë 21.03.2023, të eprorit direkt, është marrë masa disiplinore “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen e shkallës e pagës për një periudhë 1 vjecare” (larguar me doreheqje);
- \*\*\*\*\*, me detyrë “Inspektor në Dibër”, me vendimin nr. 22, datë 12.02.2021, të eprorit direkt, është marrë masa disiplinore “Vërejtje”;
- \*\*\*\*\*, me detyrë “Inspektor në Tiranë”, me vendimin nr. 202/5, datë 02.04.2021, të eprorit direkt, është marrë masa disiplinore “Vërejtje”;
- \*\*\*\*\*, me detyrë “Inspektor në Tiranë”, me vendimin nr. 203/5, datë 02.04.2021, të eprorit direkt, është marrë masa disiplinore “Vërejtje”;
- \*\*\*\*\*, me detyrë “Inspektor në Durrës”, me vendimin nr. 379, datë 31.05.2021, të eprorit direkt, është marrë masa disiplinore “Vërejtje”;
- \*\*\*\*\*, me detyrë “Inspektor në Lezhë”, me vendimin nr. 128, datë 14.06.2021, të eprorit direkt, është marrë masa disiplinore “Vërejtje”;
- \*\*\*\*\*, me detyrë “Inspektor në Elbasan”, me vendimin nr. 1, datë 30.07.2021, të eprorit direkt, është marrë masa disiplinore “Vërejtje”;
- \*\*\*\*\*, me detyrë “Inspektor në Gjirokastrë”, me vendimin nr. 2, datë 26.11.2022, të eprorit direkt, është marrë masa disiplinore “Vërejtje”;
- \*\*\*\*\*, me detyrë “Inspektor në Gjirokastrë”, me vendimin nr. 3, datë 26.11.2022, të eprorit direkt, është marrë masa disiplinore “Vërejtje”;

- \*\*\*\*\* , me detyrë “*Inspektor në Elbasan*”, me vendimin nr. 4, datë 26.11.2022, të eprorit direkt, është marrë masa disiplinore “*Vërejtje*”.

Për **6 punonjës**, Komisioni i Disiplinës, në përfundim të ecurisë disiplinore, në mbështetje të germës ç), të nenit 58, të ligjit, ka aplikuar masën disiplinore “*largim nga shërbimi civil*” dhe bëhet fjalë për punonjësit e evidentuar në vijom:

- \*\*\*\*\* , me detyrë “*Kryeinspektor në Tiranë*”, larguar me vendimin nr. 1141/14, datë 13.06.2020, të Komisionit të Disiplinës;
- \*\*\*\*\* , me detyrë “*Inspektor në Korçë*”, larguar me vendimin nr. 1929/1, datë 18.09.2020, të Komisionit të Disiplinës;
- \*\*\*\*\* , me detyrë “*Inspektor*”, larguar me vendimin nr. 2115/1, datë 11.11.2021, të Komisionit të Disiplinës;
- \*\*\*\*\* , me detyrë “*Inspektor në Lezhë*”, larguar me vendimin nr. 2175/7, datë 05.11.2021, të Komisionit të Disiplinës;
- \*\*\*\*\* , me detyrë “*Inspektor në Durrës*”, larguar me vendimin nr. 2115/2, datë 11.11.2021, të Komisionit të Disiplinës;
- \*\*\*\*\* , me detyrë “*Inspektor në Tiranë*”, me detyrë “*Inspektor në Durrës*”, larguar me vendimin nr. 2115/3, datë 11.11.2021, të Komisionit të Disiplinës.

U konstatua se, në institucionin e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, ka pasur **25 raste** të aplikimit të masave disiplinore, të parashikuara në nenin 58, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, nga të cilat **13 raste** janë ankimuar në gjykatë dhe janë në proces.

Institucioni duhet të informojë Komisionerin lidhur me përfundimin e proceseve gjyqësore, si dhe ecurinë e këtyre masave administrative.

**9. Vlerësimi i rezultateve në punë dhe si është zhvilluar ky proces për gjashtëmujorin e parë të vitit 2023. Si materializohet procedura e vlerësimit dhe detyrimet ligjore që ligji i ka vendosur aktorëve të këtij procesi gjatë periudhës së vlerësimit (Zyrtari Raportues, Zyrtari Kundërfirmues, Zyrtari Autorizues).**

Në zbatim të programit të mbikëqyrjes, u verifikua procedura e ndjekur nga institucioni për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil, për 6 mujorin e parë të vitit 2023, në përputhje me kërkesat e nenit 62, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe Vendimin nr. 109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”, ndryshuar, me Vendimin nr. 252, datë 30.3.2016, të Këshillit të Ministrave, “*Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”*”.

Në kuptim të dispozitave ligjore si më sipër, vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësit civilë të konfirmuar, është një proces që duhet të realizohet çdo 6 muaj, ndërsa për nëpunësit

civilë në periudhë prove, periudha e vlerësimit është vjetore dhe llogaritet nga data e emërimit të tij.

Gjatë procesit të verifikimit në institucionin e mbikëqyrur, u konstatua se, *formularët e vlerësimit të punës janë hartuar, sipas formatit të miratuar në Lidhjen nr. 2*, pjesë e VKM-së nr. 109, datë 26.2.2014, e ndryshuar, ku janë materializuar të gjitha rubrikat që kanë të bëjnë me të dhënat personale (*ndarja A*); të dhënat për kontekstin e punës ku identifikohen objektivat e institucionit dhe të njësisë organizative ku bën pjesë nëpunësi (*ndarja B*); objektivat dhe matësit e performancës, ku duke mbajtur parasysh përshkrimin e punës, bëhet vlerësimi për çdo objektiv (*ndarja C*); sjellja profesionale, e cila ka të bëjë me saktësinë në punën e kryer dhe realizimin në kohë, punën në grup e marrëdhëniet me kolegët, kërkesën për këshillim, aftësinë menaxheriale për nëpunësit në pozicionet e nivelit të ulët e të mesëm drejtues (*ndarja Ç*); vlerësimi i përgjithshëm i rezultateve në punë ku bëhet një vlerësim i përmbledhur i arritjes së objektivave kryesore të punës nga nëpunësit.

Në zbatim të programit të punës, për të gjithë nëpunësit, që, në momentin e mbikëqyrjes, punonin në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, u verifikuan vlerësimet e rezultateve në punë për 6 mujin e parë të vitit 2023.

Duke patur parasysh katër nivelet e vlerësimit “*shumë mirë*”, “*mirë*”, “*kënaqshëm*” dhe “*jokënaqshëm*”, nga verifikimet e kryera, vlerësimi përfundimtar i nëpunësve, paraqitet si më poshtë:

*Tabela nr. 1: Niveli i vlerësimit për gjashtë mujin e parë të vitit 2023*

Periudha e vlerësimit	Janar – Qershor 2023			
	<i>Shumë mirë</i>	<i>Mirë</i>	<i>Kënaqshëm</i>	<i>Jo kënaqshëm</i>
Niveli i vlerësimit përfundimtar				
Numri i nëpunësve të vlerësuar për çdo nivel	51	53	12	-
<b>Totali</b>	<b>116</b>			

Rezulton se, nga **153 pozicione pune** pjesë e shërbimit civil, vlerësimi i rezultateve në punë për periudhën janar- qershor 2023 është kryer për **116 nëpunës**, ndërsa për **37 nëpunës** nuk është kryer vlerësimi i rezultateve në punë për këtë periudhë, për arsyet e evidentuara si më poshtë:

- ✓ **18 pozicione pune** rezultuan vakante në momentin e realizimit të mbikëqyrjes;
- ✓ **8 pozicione pune** pjesë e shërbimit civil janë plotësuar me punonjës përmes programit të ekselencës;
- ✓ Për **1 nëpunës** nuk është kryer vlerësimi për periudhën janar- qershor 2023, pasi ka qënë me raport mjekësor 6 mujor;
- ✓ Për **5 nëpunës** nuk është kryer vlerëimi pasi kanë qënë me raport leje lindje;
- ✓ Ndërsa **5 punonjës** janë ende në periudhë prove.



Nga të dhënat e vlerësimit të nëpunësve civilë si më sipër, rezulton se, **51 nëpunës** janë vlerësuar me nivelin 1 “*shumë mirë*”, që është niveli më i lartë i vlerësimit; **53 nëpunës** janë vlerësuar me nivelin 2 “*mirë*”; dhe **12 nëpunës** janë vlerësuar në nivelin 3 “*kënaqshëm*”.

Përsa më sipër, konstatohet se në këtë rast janë përdorur në mënyrë proporcionale të gjitha nivelet e vlerësimit. Në vijim, zyrtarët raportues të kujdesen që të shmangin vlerësimet subjektiv,e duke plotësuar hap pas hapi të gjitha kërkesat që përcakton dispozita ligjore e sipërcituar për vlerësimin.

Sa i përket anës procedurale në të cilën materializohet ky proces, nga verifikimi i formularëve të vlerësimit të vënë në dispozicion nga sektori i e menaxhimit të burimeve njerëzore, për periudhën e vlerësimit janar- qershor, viti 2023, konstatohet se:

- ✓ Në të gjitha rastet, fazat e ndërmjetme (planifikimi dhe bisedimet e ndërmjetme), nëpër të cilat duhet të kalojë procesi i vlerësimit të rezultateve në punë, **nuk janë respektuar nga eprori direkt i nëpunësit në proces vlerësimi.**
- ✓ Nëpunësit përgjegjës për kryerjen e procedurës së vlerësimit, Zyrtari raportues, Zyrtari kundërfirmues dhe Zyrtari autorizues, janë zëvendësuar në përputhje me kërkesat e Vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, në ato raste kur është vlerësuar e nevojshme.
- ✓ Procedura e ndjekur në rastet e mosmarrëveshjeve midis Zyrtarëve raportues, kundërfirmues apo autorizues, gjatë realizimit të procesit të vlerësimit të rezultateve në punë, **nuk paraqet mangësi** sa i përket materializimit në formularin e vlerësimit.
- ✓ Vlerësimi i rezultateve në punë është kryer sipas formatit që jepet në lidhjen nr. 2, bashkëlidhur Vendimit nr. 109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”, i ndryshuar, por, të dhënat që kërkohe në ndarjet/nënndarjet përkatëse **të formularit, rubrika komente, në 51 raste ku nëpunësit janë vlerësuar me nivelin 1 (shumë mirë), rezulton e pa plotësuar.**
- ✓ Respektimi i afatit të vlerësimit të rezultateve në fund të periudhës së provës dhe më tej, pas konfirmimit si nëpunës civil, **ka ndjekur kërkesat ligjore** të parashikuara.

Sa i takon fazave të ndërmjetme, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, pranë institucionit të mbikëqyrur sqaroi se, fazat e kërkuara gjatë procesit të vlerësimit **janë zhvilluar verbalisht** midis nëpunësit dhe zyrtarit raportues, por **nuk janë të materializuara** në (*shënime, procesverbale, etj.*). Vetëm “*Formulari i Vlerësimit të Punës*”, si i vetmi dokument që përmban të dhëna në lidhje me vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë është administruar në dosjen e personelit të çdo nëpunësi.

Nga këqyrja e formularit të vlerësimit, vërehet se, **ai është i rregullt** nga pikëpamja formale, pasi, është nënshkruar nga të gjithë personat përgjegjës, të ngarkuar nga ligji për kryerjen e procedurës së vlerësimit (*zyrtari raportues/ zyrtari kundërfirmues/ zyrtari autorizues*).

#### **10. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të lirimit nga shërbimi civil si rezultat i dorëheqjes dhe për shkak të ligjit.**

Instituti i përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil është sanksionuar në Kreun XII, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, konkretisht në nenin 63, të këtij kreu parashikohen rastet e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, ato janë nëpërmjet: a) lirimit nga shërbimi civil; b) largimit nga shërbimi civil, si masë disiplinore; si dhe c) pranisë së një shkakut të parashikuar nga neni 65, i këtij ligji.

Për periudhën objekt mbikëqyrje u konstatua se, kanë përfunduar marrëdhënien në shërbimin civil **23 punonjës** të cilët, paraqiten nominalisht të grupuar sipas arsyes së përfundimit të saj.

- ✓ Në nenin 64, të ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar, parashikohen rastet e përfundimit të marrëdhënies së punësimit në shërbimin civil, nëpërmjet “Dorëheqjes”. Për periudhën objekt mbikëqyrje u konstatua se, ka përfunduar marrëdhëniet në shërbimin civil me kërkesë të nëpunësit në **12 raste**, të evidentuara si më poshtë:

#### **Për vitin 2020:**

- \*\*\*\*\*<sub>1</sub>, me detyrë “Inspektor në Korçë”, me shkresën nr. 581/1 prot., datë 02.03.2020, të titullarit, është liruar nga detyra dhe i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare;
- \*\*\*\*\*<sub>2</sub>, me detyrë “Inspektor në Durrës”, me urdhër nr. 1019/1, datë 26.05.2020, të titullarit, është liruar nga detyra dhe i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare.

#### **Për vitin 2021:**

- \*\*\*\*\*<sub>1</sub>, me detyrë “Inspektor Berat”, me urdhër nr. 2006/1, datë 23.09.2021, të titullarit, është liruar nga detyra dhe i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare.

#### **Për vitin 2022:**

- \*\*\*\*\*<sub>1</sub>, me detyrë “Kryeinspektor ISHPSHSH”, me urdhër nr.617/1, datë 23.01.2022, është liruar nga detyra dhe i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare;
- \*\*\*\*\*<sub>2</sub>, me detyrë “Inspektor në Gjorkastër”, me urdhër nr. 837/3, datë 28.04.2022, të titullarit, është liruar nga detyra dhe i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare;
- \*\*\*\*\*<sub>3</sub>, me detyrë “Inspektor në Gjirrokastër”, me urdhër nr. 1008/1, datë 17.05.2022, të titullarit, është liruar nga detyra dhe i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare;
- \*\*\*\*\*<sub>4</sub>, me detyrë “Inspektor në Berat”, me urdhër nr. 1728/1, datë 26.10.2022, të titullarit, është liruar nga detyra dhe i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare;
- \*\*\*\*\*<sub>5</sub>, me detyrë “Përgjegjës Sektori Shkodër”, me urdhër nr. 2584/1, datë 23.12.2022, të titullarit, është liruar nga detyra dhe i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare.

#### **Për vitin 2023:**

- \*\*\*\*\*<sub>1</sub>, me detyrë “Inspektor”, me shkresën nr. 1122/1 prot., datë 17.07.2023, të titullarit, është liruar nga detyra dhe i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare;

- \*\*\*\*\* me detyrë “*Inspektor në Kukës*”, me urdhër nr. 429/1, datë 02.03.2023, të titullarit, është liruar nga detyra dhe i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare;
- \*\*\*\*\* me detyrë “*Përgjegjës Sektori në Lezhë*”, me urdhrin nr. 529/1, prot., datë 02.03.2023, të titullarit, është liruar nga detyra dhe i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare;
- \*\*\*\*\* me detyrë “*Përgjegjës Sektori në Sarandë*”, me urdhër nr. 693/1, datë 13.04.2023, të titullarit, është liruar nga detyra dhe i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare.

Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, për shkak të plotësimit të moshës për daljen në pension të plotë plegërie është përcaktuar në germën c), pika 1, e nenit 65, të ligjit nr.152/2013, i ndryshuar, në institucionin e mbikëqyrur, kanë përfunduar marrëdhënien në shërbimin civil për këtë arsye, **6 punonjës**, të evidentuar nominalisht si më poshtë:

- \*\*\*\*\* me detyrë “*Inspektor në Berat*”, me shkresën nr. 371/15 prot., datë 07.02.2020, të titullarit, është liruar nga detyra dhe i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare;
- \*\*\*\*\* me detyrë “*Inspektor në Drejtorinë Qëndrore*”, me shkresën nr. 1391/3 prot., datë 21.06.2021, të titullarit, është liruar nga detyra dhe i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare;
- \*\*\*\*\* me detyrë “*Inspektor në Berat*”, me urdhrin nr. 2247, prot., datë 11.10.2021, të titullarit, është liruar nga detyra dhe i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare;
- \*\*\*\*\* me detyrë “*Inspektor pranë Kryeinspektorit*”, me urdhër nr. 76, datë 11.10.2021, të titullarit, është liruar nga detyra dhe i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare;
- \*\*\*\*\* me detyrë “*Inspektor në Shkodër*”, me urdhër nr. 98, datë 20.05.2023, të titullarit, është liruar nga detyra dhe i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare;
- \*\*\*\*\* me detyrë “*Inspektor në Korçë*”, me urdhër nr. 857, datë 24.05.2023, të titullarit, është liruar nga detyra dhe i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare.

✓ Për shkak të dy vlerësimeve të njëpasnjëshme, me nivelin 4 (jo kënaqshëm), sipas parashikimit të germës c), pika 1, të nenit 66, të ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar, ka përfunduar marrëdhënien në shërbimin civil, për **3 punonjësit**, e evidentuar më poshtë:

- \*\*\*\*\* me detyrë “*Përgjegjës në Sektorin e Inspektimit Fier*”, me urdhër nr.3682/1, datë 19.10.2022, të titullarit, është liruar nga shërbimi civil;
- \*\*\*\*\* me detyrë “*Inspektor në Fier*”, me urdhrin nr. 183 prot., datë 22.08.2022, të titullarit, është liruar nga shërbimi civil;
- \*\*\*\*\* me detyrë “*Inspektor në Fier*”, me urdhër nr. 3681/2, datë 19.10.2022, të titullarit, është liruar nga shërbimi civil.

*Për shkak të ristrukturimit të institucionit*, në mbështetje të pikës 1, germa a/1), të nenit 66, është liruar nga shërbimi civil punonjësi \*\*\*\*\*\*, me detyrë “*Drejtor në Drejtorinë e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë*”, me urdhër nr. 293, datë 09.02.2021, ashtu si e kemi evidentuar edhe më sipër, cili është ankuar në gjykatë dhe aktualisht është në proces gjykimi, në Gjykatën e Apelit.

Nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, me aktin nr. 329, datë 14.02.2023, është konstatuar përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, për punonjësin \*\*\*\*\*\*, sipas parashikimit të pikës 1, germa a), të nenit 65, të ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar.

**Konkluzion:** Në të gjitha rastet e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil për punonjësit e evidentuar nominalisht në këtë nënçështje të materialit, sipas dokumentacionit të administruar, konstatohet se, nga ana e njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, pas verifikimit të ekzistencës së shkakut ligjor të kërkuar për secilin rast, ***kanë dalë në afat*** aktet e deklaramit apo konstatimit të përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil.

## **11. Dosjet e personelit**

Në zbatim të programit, u verifikuan dosjet e personelit për të vlerësuar nëse ato janë krijuar dhe administrohen në përputhje me përcaktimet e nenit 17, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe sipas kërkesave të Vendimit nr. 833, datë 28.10.2020, të Këshillit të Ministrave “*Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qëndror të Personelit*”.

Nisur nga përmbajtja e dispozitave ligjore si më lart, në dosjen individuale të çdo nëpunësi civil, duhet të jenë të përfshira dokumente me të dhënat personale të karakterit teknik, profesional, si dhe të dhëna të tjera sipas lidhjes 1 dhe 2, bashkëlidhur aktit nënligjor, që rregullon në mënyrë specifike këtë aspekt.

Më konkretisht, në dosjet personale të nëpunësve, duhet të administrohet dokumenti i identifikimit (*fotokopje e letërnyoftimit*); dokumenti mbi gjendjen civile (*certifikata e gjendjes familjare*); dokumentet lidhur me nivelin e edukimit arsimor dhe fushën e studimeve (*fotokopje e noterizuar e diplomës së shkollës së lartë dhe lista e notave*); dokumentet që vërtetojnë fillimin e marrëdhënieve të punës në pozicionin përkatës (*akti i emërimit*); aktet që provojnë procesin e deklaramit të statusit të punësimit; aktet që vërtetojnë gjendjen gjyqësore, apo vërtetimi i gjendjes shëndetësore (*Raporti Mjekësor*).

Konstatohet se, në dosjet individuale të nëpunësve nuk ka mangësi dhe ato janë të sistemuara dhe ruhen në kushte të përshtatshme në ambientet e institucionit dhe administrohen nga Përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Përgjithshme pranë Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, i cili është nëpunësi përgjegjës për menaxhimin e

burimeve njerëzore, në kuptim të Kreut I, pika 4, të vendimit nr.117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

Në mënyrë të hollësishme këto akte janë materializuar në **aneksin nr. 2** “Respektimi i kërkesave të përgjithshme, sipas nenit 21 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për punonjësit që janë të emëruar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, deri në datën 26.02.2014, si dhe të punonjësve që janë aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil”, që është pjesë përbërëse e këtij raporti.

Konstatohet se dosjet individuale të nëpunësve janë të sistemuara, ruhen në kushte të përshtatshme në ambientet e institucionit dhe administrohen nga personi përgjegjës i ngarkuar për të kryer detyrën lidhur me burimet njerëzore në institucionin e mbikëqyrur, i cili është nëpunësi përgjegjës për menaxhimin e burimeve njerëzore, në kuptim të Kreut I, pika 4, të vendimit nr.117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

**Nga administrimi i të dhënave konstatohet se**, në këtë subjekt, ka gjithsej **165** pozicione pune të miratuara, nga të cilat **153 pozicione pune janë pjesë e shërbimit civil**, ku gjendja e pozicioneve të punës rezulton si më poshtë:

- ✓ **127** pozicione të plotësuara;
- ✓ **18** pozicione janë të lira;
- ✓ **8** pozicione pune të plotësuar me student të ekselencës.

Referuar të dhënave të administruara nga dosjet personale për **127** nëpunës civilë të institucionit të kontrolluar, në vijim do të evidentojmë disa të dhëna statistikore në lidhje me moshën mesatare dhe përkatësinë gjinore të nëpunësve si edhe me kategorinë e institucioneve të arsimit të lartë ku nëpunësit janë diplomuar:

- ✓ **61** nëpunës civilë janë gra;
- ✓ **66** nëpunës civilë janë burra;
- ✓ Moshë mesatare e grave është afërsisht 40 vjeç;
- ✓ Moshë mesatare e burrave është afërsisht 53 vjeç;
- ✓ Moshë mesatare e numrit total të nëpunësve civilë është afërsisht 46 vjeç.

Për sa i përket arsimit të nëpunësve, rezulton se **102** nëpunësit civilë zotërojnë diploma të studimeve të larta universitare, nga Universitete Publike të Republikës së Shqipërisë, **23** nëpunësit civilë zotërojnë diploma të studimeve të larta universitare, nga Universitete Private dhe në **2** raste nëpunësit civilë zotërojnë diploma të studimeve të larta universitare, nga univeristete jashtë Republikës së Shqipërisë dhe i kanë njehsuar nga Ministria e Arsimit.

**Konkluzion:** Sa më sipër, vlerësohet se, dosjet e personelit **janë të plotësuara në përputhje me ligjin** dhe zyrtari i ngarkuar me ruajtjen dhe administrimin e dosjeve të personelit pranë këtij institucioni ka treguar kujdes duke përfshirë të gjitha dokumentet me të dhënat personale të karakterit teknik, profesional, si dhe të dhëna të tjera, sipas përcaktimeve të nenit 17, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe sipas kërkesave të Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

## **11.a) Regjistri Qendror i Personelit**

Regjistri i personelit është një dokument që duhet të krijohet sipas kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 833, datë 28.10.2020, të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qëndror të Personelit”, Regjistri Qendror i Personelit si sistemi që ruan dhe përpunon të dhënat elektronike për burimet njerëzore aktive në të gjitha institucionet e administratës shtetërore, është krijuar dhe administrohet nga Departamenti i Administratës Publike për këtë institucion.

Institucioni i mbikëqyrur ka akses në sistem dhe e ushtron këtë funksion nëpërmjet përgjegjëses së administratës, financës dhe teknologjisë së informacionit. Në sistem bëhet plotësimi dhe përditësimi i të dhënave të parashikuara në aktin nënligjor përkatës që rregullon këtë aspekt të administrimit të shërbimit civil.

**Konstatim:** Gjatë mbikëqyrjes u administrua *struktura analitike e institucionit*, referuar urdhrin nr. 156, datë 24.11.2020, të Kryeministrit “Për Miratimin e Strukturës dhe Organikës së Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore”.

Bazuar në germën “ë”, të nenit 7 të ligjit nr. 152/2013 “Për shërbimin civil”, i ndryshuar si dhe në vendimin nr. 833, datë 28.10.2020, të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qëndror të Personelit”, nëpërmjet shkresës nr. 244 prot., datë 03.02.2022, të Drejtorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të ISHPSHSH-së, i është konfirmuar aksesimi në sistemin RQP, si përdorues të këtij regjistri nëpunëses Laureta Pasholli, me detyrë “Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore”, në nivelin e tretë të aksesimit.

Gjatë verifikimit u konstatua se sistemi HRMIS, Regjistri Qendror i Personelit, përmban një grup të dhënash që plotësohen dhe përditësohen nga njësia përgjegjëse DAP dhe një grup të dhënash që plotësohen dhe përditësohen nga institucioni. Ndërsa, platforma *administrata.al*, që në momentin e hakerimit të sistemeve elektronike qeveritare, gjatë verës së vitit 2022, e në vijim nuk ka funksionuar.

Për shkak të numrit të lartë të nëpunësve në këtë institucion, bazuar në këtë dokumentacion (në datën 25.09.2023), u realizua një përzgjedhje për **10** nëpunës civil të këtij institucioni, me qëllim verifikimin e të dhënave të tyre, të hedhura në sistemin HRMIS, krahasuar me të dhënat që disponojnë në dosjet e tyre personale.

Bëhet fjalë për nëpunësit si më poshtë vijon:

- \*\*\*\*\* me detyrë “Zëvendëskryeinspektor/Drejtor” në “Drejtorinë e Inspektimit të Punës”;
- \*\*\*\*\* me detyrë “Inspektor” pranë Kryeinspektorit;
- \*\*\*\*\* me detyrë “Kryeinspektor” në “Drejtorinë Rajonale të ISHPSHSH-së, Tiranë, Rajoni I”;
- \*\*\*\*\* me detyrë “Kryeinspektor” në “Drejtorinë Rajonale të ISHPSHSH-së, Shkodër, Rajoni V”;
- \*\*\*\*\* me detyrë “Kryeinspektor” në “Drejtorinë Rajonale të ISHPSHSH-së, Dibër, Rajoni III”;
- \*\*\*\*\* me detyrë “Përgjegjës Sektori” në Sektorin e Inspektimit Elbasan, në “Drejtorinë Rajonale të ISHPSHSH-së, Korçë, Rajoni IV”;
- \*\*\*\*\* me detyrë “Inspektor” në Sektorin e Inspektimit Shkodër, në “Drejtorinë Rajonale të ISHPSHSH-së, Shkodër, Rajoni V”;
- \*\*\*\*\* me detyrë “Kryeinspektor” në “Drejtorinë Rajonale të ISHPSHSH-së, Gjirokastër, Rajoni VI”;
- \*\*\*\*\* me detyrë “Inspektor” në Sektorin e Inspektimit Sarandë, në “Drejtorinë Rajonale të ISHPSHSH-së, Gjirokastër, Rajoni VI”;
- \*\*\*\*\* me detyrë “Inspektor” në Sektorin e Inspektimit, Dibër, në “Drejtorinë Rajonale të ISHPSHSH-së, Dibër, Rajoni III”.

Nga verifikimi rezultoi se, për të **10** nëpunësit civil që u përzgjedhën për verifikim, njësia njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, **ka plotësuar çdo rubrikë të përcaktuar në sistem** ku përfshihen, akti i emërimit i nëpunësit, të dhënat individuale lidhur me identifikimin e nëpunësit, edukimi, kualifikimet, gjuhët e huaja, masat disiplinore nëse ka, përvoja e punës (sipas librezës së punës apo të dhënave të gjeneruara nga sistemi e-albania), historikun e marrëdhënies së punës ndër vite të cilin e gjeneron sistemi (aktin e emërimit për herë të parë në institucion, ndryshimi i pozicionit të punës për shkak të ristrukturimit të institucionit, lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë apo transferimit të përkohëshëm), grada nëse ka, vlerësimi i rezultateve në punë i cili realizohet në mënyrë periodike çdo 6 muaj të vitit kalendarik, përfundimi i marrëdhënies së punës në shërbimin civil, për këtë shkak edhe përfundimi i marrëdhënies financiare me institucionin. Në të gjitha këto raste në sistem, hidhet numri dhe data e aktit me të cilin është kryer veprimi administrativ përkatës.

\*  
\*                      \*

Aktet administrative që dokumentojnë këtë proces, sipas objektit të tij, janë materializuar në tabelat e mëposhtme përkatëse për institucionin Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore të cilat janë pjesë përbërëse e këtij raporti.

1. **Aneksi 1** - *“Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punojnë në pozicione të shërbimit civil, në momentin e mbikëqyrjes”.*
2. **Aneksi 2** - *“Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civilë, i ndryshuar, për punonjësit që janë të emëruar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil (në datën 26.02.2014), si dhe të punonjësve që janë aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil”.*

## **K O M I S I O N E R I**

**Pranvera STRAKOSHA**